# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com








Viti XXIII - Nr. 7309 E diel 1 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)


Opinioni i Ditës

Nga BEN ANDONI

## Mafia shqiptare një institucion, që duhet "vlerësuar"



Pak ditë më parë një intervistë e kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë në Vlorë, Skënder Halluci në median vizive ka kaluar sikur të mos kishte thënë ...


Vijon në faqen 21




Opinioni i Ditës

Nga DESADA METAJ

## Lotët e Gertës dhe mallëngjimi kolektiv i shqiptarëve

Ka mjaftuar recitimi i një fjalimi në kufijtë mizorë të patetikes që sot në lajmet dhe rrjetet sociale të vërshojnë komentet mbështetëse për një zonjë ...


Vijon në faqen 22




"Pyetini qeveritarët si e paguajnë luksin"

# Lu: Rrëzojeni qeverinë nëse s'ju përgjigjet, kjo është demokraci

Ambasadori i SHBA, mesazh për të rinjtë. PD dhe LSI: Donald Lu ka shumë të drejtë

Nga DARINA TANUSHI

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu lëshoi dje, një mesazh të qartë për të gjithë shqiptarët dhe qeverinë. Nga Rrësheni, gjatë një takimi me të rinjtë, ambasadori Lu u tha ...


Në faqen 3


EMRAT E MATURANTEVE QE HYJNE TE SHKENCAT E NATYRES DHE FILOLOGJIKU

# UNIVERSITETI I TIRANES, FITUESIT E RAUNDIT II

Shpallet lista e atyre që kanë të drejtën e studimit edhe tek Gjuhët e Huaja dhe Shkencat Sociale. Sot hapet portali online, si bëhet regjistrimi



*(Në foto)* Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë


Në faqet 9-12


"MILOSAO"

## At Zef Pllumi, si e persekutonin 'eprorët' e Kishës në demokraci


Suplement


LAPRAKE

## Plagosja e 4-fishtë, dëshmia e "shënjestrës": Si ndodhi sherri


Në faqen 6


PARLAMENTI RURAL

## Mirditorja në Kuvend: Duam ujë e rrugë. Ruçi: Të bëjmë 'fshatin e ri'


Në faqen 4


PARALAJMERIMI

## Të hënën rinis aksioni, kush nuk merr kuponin do të gjobitet


Në faqen 5


INTERVISTA



## Pensionet në Itali, flet specialistja: Kushtet si ta merrni pagesën në Shqipëri


Në faqen 7


Mashtrimi/ Dhoma e gruas që zhvati 60 milionë lekë, me krevat bebesh e fustan nusërie

# Mjeku: Enertila, sëmundja e trashëguar nga nëna

*Drejtori i ambulancës në Manzë: Pseudologjia, derivat i epilepsisë së pakuruar*

Nga KLODIANA HAXHIAJ

Historia e pazakontë e 27-vjeçares Enertila Beqja, e cila akuzohet se nëpërmjet mashtrimit në "Facebook" i ka zhvatur 60 milionë lekë të vjetra përgjegjësit të Postës në Manzë, Barush Ahmetajt, ka tronditur shumëkënd dhe



në veçanti banorët e fshatit Manzë në Durrës. Një ditë pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Durrësit la në burg të renë, "Gazeta Shqiptare" zbardh detaje të reja në lidhje me ngjarjen. Nisur nga "misteri" i kësaj historie, dje "GSH" kontaktoi ...


Në faqen 8

# SITUATA POLITIKE

## REAGIMET

**Nënkryetari i LSI-së: Prokuroria duhej të kishte nisur hetimet**

# Luan Rama: Radarët nuk punojnë, shteti në gjumë, trafikantët punojnë

Nënkryetari i LSI-së, Luan Rama i bëri thirrje dje, qeverisë që të zgjohet nga gjumi dhe të shohë funksionimin e radarëve për të kapur trafikantët. Në një status në rrjetin social, "FB", Luan Rama shkroi dje: "Radarët nuk punojnë, shteti në gjumë! Në punë janë vetëm trafikantët!... Po e them drejtpërdrejt: Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD - thënë më thjeshtë sistemi i radarëve) në Republikën e Shqipërisë, anëtare e NATO-s, nuk punon! Për të qenë më i saktë, ka gati dy vjet, që ky sistem nuk është operacional! Ndërkohë, pagesat nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes për mirëmbajtjen e këtij sistemi janë kryer rregullisht dhe në kohë!". "Çfarë duhet të ndodhë më shumë se kaq që shteti të zgjohet nga gjumi dhe ligjit të kryejnë detyrën?! Çfarë pret prokuroria që nuk nis hetimet? Apo që trafikantët e kriminelët të vazhdojnë të bëjnë siç kanë bërë?! Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit e ka denoncuar këtë realitet mbi një muaj më parë! Dhjetë ditë më parë, unë publikisht i kam kërkuar prokurorisë të nisë hetimet! Çfarë pritet akoma?! Mosveprimi i shtetit është bashkëfajësi në krim! Edhe një herë po e përsëris: Radarët nuk punojnë! Shteti ende në gjumë! Në punë janë vetëm trafikantët!...", u shpreh Luan Rama.


Nënkryetari i LSI-së, Luan Rama


Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

Opozita mbështet deklaratën e ambasadorit të SHBA, kreu i PD: U shpenzuan 2 mln $ për udhëtime

# "Rrëzimi i qeverisë", Basha: Ambasadori ka të drejtë

## *Rrokaj: Nëse qeveria hesht, qytetarët do të marrin në dorë vendosjen e demokracisë*

Darina Tanushi

Opozita mbështeti dje, deklaratën e ambasadorit amerikan Donald Lu. PD dhe LSI komentuan menjëherë thirrjen e LU-së, drejtuar të rinjve që, nëse kanë pakënaqësi për qeverinë mund ta rrëzojnë atë. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha shkroi në rrjetin social se kjo qeveri në gjysmën e parë të vitit ka shpenzuar 2 milionë dollarë vetëm për udhëtime, ndërsa 14 milionë dollarë për rikonstruksione zyrash dhe orendish. Këto para sipas Bashës, janë të mjaftueshme për të siguruar e të gjithë nxënësve të Shqipërisë. "Ambasadori ka të drejtë në mesazhin për të rinjtë: "Ju jetoni në demokraci. Ju duhet të kërkoni dhe nëse qeveria nuk ju përgjigjet, ju e rrëzoni atë. Kështu funksionon demokracia. Në demokraci, përgjegjësinë dhe pushtetin e keni ju.", shkroi dje, Lulzim Basha. "Ndërsa përgjigja për pyetjen që çdo shqiptar duhet t'i bëjë qeverisë, kur ajo refuzon të paguajë librat shkollorë nga buxheti, është e thjeshtë: Vetëm për gjysmën e parë të vitit, qeveria shpenzoi: 1. Për bileta/udhëtime: rreth 2 milionë dollarë. 2. Për orendi/rikonstruksion zyrash: rreth 14 milionë dollarë", u shpreh Basha. "Kaq pará janë të mjaftueshme për të siguruar librat shkollorë për të gjithë nxënësit e Shqipërisë. Ashtu siç ka premtuar, Partia Demokratike do të depozitojë në Kuvend propozimin për të financuar nga buxheti librat e shkollës për të gjithë fëmijët e Shqipërisë", propozoi kreu i PD-së.


Kreu i PD-së, Lulzim Basha


Deputeti i LSI-së, Shezai Rrokaj

> **RROKAJ**
>
> "Mesazhi i Donald Lu-së për arsimin falas konfirmon kauzën e LSI-së se tekstet shkollore në arsimin parauniversitar duhet të jenë falas"

**LSI**

Deputeti i LSI-së, profesori Shezai Rrokaj deklaroi dje, se "Mesazhi i Donald Lu-së për arsimin falas konfirmon kauzën e LSI-së se tekstet shkollore në arsimin parauniversitar duhet të jenë falas". "Qeveria është në kushtet e cenimit të ligjit të arsimit parauniversitar, i cili në nenin 5, pika 2 sanksion se "Arsimi i detyrueshëm dhe ai i mesëm e i lartë janë falas. Nga verifikimi zyrtar nëpërmjet kërkimit parlamentar rezulton se vende si: Franca, Gjermania, Italia, Greqia ..., por edhe vendet si: Rumania, Serbia, Kroacia, Maqedonia e Kosova i kanë tekstet shkollore falas", tha deputeti i LSI-së. Sipas tij, "Qeveria jonë trajton me tekste falas vetëm disa kategori vulnerabël, gjithsej 16, me një buxhet rreth 300 mijë lekë. Lidhur me sa paraqita më lart, dalin disa çështje me rëndësi për konceptin e qeverisë për edukimin: Së pari, qeveria shkel ligjin e parlamentit shqiptar. Arsim i detyrueshëm nuk do të thotë vetëm se individët e kësaj moshe duhet të ndjekin vitet e edukimit të përcaktuara në ligj, por në radhë të parë, se shteti detyrohet ta japë falas arsimimin nisur nga e drejta publike e edukimit të shoqërisë". "Qeveria jonë këtë koncept e ka kuptuar si detyrim për "të varfrit". Në fakt konceptí "Arsim i detyruar" nuk ka lidhje me politikat e qeverisë ndaj shtresave në nevojë, por me vlerësimin dhe detyrimin e shtetit për edukimin shoqëror publik të individëve. Së dyti, dikur ne mbaheshim si i vetmi vend që dallonte për konsequencën ndaj idealeve absurde, por edhe sot përsëri ndryshe nga të tjerët: vendi model për mungesën e vëmendjes ndaj arsimit. Së treti, a e dini se sa kushton afërsisht gjithë kjo histori, pra që shteti të marrë përsipër tekstet: jo më shumë sesa 6-7 milionë euro", tha Rrokaj. "Shikoni ku katandiset shteti, ku lëvizin në xhepa miliona para droge, koncesionesh e tenderësh, fasadash apo makina luksoze e dieta udhëtimesh, siç shprehet ambasadori Lu. Fytyra e një shteti duket te rëndësia që merr arsimimi. Shqipëria është vendi i fundit në Evropë për buxhetin e arsimit, i cili është fiksuar rreth 3% e PBB-së. Kjo çështje, si dhe mjaft të tjera do të jenë kali i betejës së LSI-së gjatë amendimit të këtij ligji. Nëse qeveria hesht për kauza qytetare, atëherë qytetarët do të marrin vetë në dorë vendosjen e demokracisë", tha Rrokaj.

> **PROPOZIMI**
>
> "Ashtu siç ka premtuar, Partia Demokratike do të depozitojë në Kuvend propozimin për të financuar nga buxheti librat e shkollës për të gjithë fëmijët e Shqipërisë", u shpreh dje, kreu i PD-së, Lulzim Basha, duke kujtuar një nga premtimet e fushatës elektorale.

**PROPOZIMI**

"Ashtu siç ka premtuar, Partia Demokratike do të depozitojë në Kuvend propozimin për të financuar nga buxheti librat e shkollës për të gjithë fëmijët e Shqipërisë", u shpreh dje, kreu i PD-së, Lulzim Basha, duke kujtuar një nga premtimet e fushatës elektorale.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: http://www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



## Ambasadori i SHBA, mesazh të fortë demokracie për të rinjtë shqiptarë

# Lu: Rrëzojeni qeverinë nëse nuk ju përgjigjet, pushtetin e keni ju

## "Pyetini qeveritarët si i paguajnë makinat luksoze dhe udhëtimet"

Darina Tanushi

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu lëshoi dje, një mesazh të qartë për të gjithë shqiptarët dhe qeverinë. Nga Rrësheni, gjatë një takimi me të rinjtë, ambasadori Lu u tha se nëse janë të pakënaqur se qeveria nuk u përgjigjet kërkesave të tyre, atëherë ta rrëzojnë atë. "Ju jetoni në demokraci. Nëse e kërkoni atë, qeveria juaj duhet të përgjigjet. Ose ju do ta rrëzoni atë. Në demokraci, përgjegjësinë dhe pushtetin e keni ju", - u shpreh qartë Donald Lu. Ambasadori Lu do të ketë një tur takimesh me të rinjtë nëpër qytete të ndryshme të vendit. "Ne kemi një mesazh për ju, por ne gjithashtu shpresojmë që të mësojmë diçka nga ju sot. Këtu është mesazhi ynë i thjeshtë: Ndryshime të mëdha po vijnë për Shqipërinë. Ju keni një rol të rëndësishëm për të luajtur në të ardhmen e Shqipërisë. Ju duhet të kërkoni ndryshim nga udhëheqësit tuaj", - u tha që në nisje të fjalës së tij, Lu, të rinjve.

"Unë besoj fuqimisht se Shqipëria do të bashkohet me Bashkimin Evropian në dekadën e ardhshme. Të gjithë ju, fëmijët dhe nipërit tuaj, do të jetojnë si qytetarë të plotë të Evropës me të gjitha të drejtat dhe privilegjet e anëtarësimit në BE. Ky ndryshim dhe shumë të tjerë po vijnë. Mos e humbisni mundësinë tuaj për të qenë pjesë e tyre. Prindërit mund t'ju tregojnë të gjitha ndryshimet që ata kanë parë: Anëtarësimi në NATO, liberalizimi i vizave me BE-në, dekriminalizimi i parlamentit tuaj, reforma gjyqësore", - u shpreh më tej ambasadori. E duke biseduar drejtpërdrejt me të rinjtë, Lu vijoi: "Por ndoshta ju do të më thoni, 'i mërzitshëm! Ajo që duam është një edukim i mirë. Ne duam punë. Ne duam atë që shohim çdo ditë në TV, nga Mbretëria e Bashkuar, nga Gjermania dhe nga Shtetet e Bashkuara'. A e dini se si mund t'i merrni të gjitha këto? Ju do t'i kërkoni. Gjëja më e mirë për brezin tuaj është se nuk jeni të lidhur ngushtë me pritjet e ulëta të së kaluarës komuniste të këtij vendi". "Ju kërkoni punë, siç kanë ata në Gjermani. Ju prisni ligje kundër korrupsionit, siç ka në Mbretërinë e Bashkuar. Dhe ju këmbëngulni për liritë personale, siç ndodh në SHBA. Ju jetoni në demokraci. Nëse e kërkoni atë, qeveria juaj duhet të përgjigjet. Ose ju do ta rrëzoni atë", - tha qartë Donald Lu. "Për shembull, në fillim të vitit shkollor, shumë njerëz, përfshirë edhe opozitën, kërkonin libra falas për studentët. Ky është një vend i vogël, nuk është një vend i pasur. Por është e arsyeshme që qytetarët të kërkojnë që qeveria të sigurojë para për të blerë libra për studentët e saj", - u shpreh Lu. Sipas tij, "dhe kur qeveria ju tregon se nuk mund ta përballojë atë, ju duhet të pyesni se si ata janë duke paguar për ndërtesat e tyre qeveritare, makinat e tyre luksoze dhe udhëtimet e tyre në vend të huaj. Në demokraci, përgjegjësinë dhe pushtetin e keni ju. Ne presim me padurim ditën kur ju të jeni udhëheqës të Shqipërisë. Ne e dimë se brezi juaj do të jetë më i mirë se gjenerata e atyre në udhëheqjen e Shqipërisë drejt së ardhmes së saj evropiane".



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu

**ZGJIDHJA**

Partia e ish-deputetit Koço Kokëdhima, "Zgjidhja" mbështeti dje, deklaratën e Lu. "Zgjidhja do të jetë në krah dhe në udhëheqje të popullit, që, përmes ndryshimeve demokratike, t'ua marrim pushtetin mafies dhe kryetarëve të partive të vjetra dhe t'ua kthejmë shqiptarëve të thjeshtë. Të rrëzojmë e përmbysim këtë elitë politike!" - tha Kokëdhima.

## Kreu i grupit të LSI: Qeveria po kontrollon strukturat

# Vasili: Lu e Vlahutin t'i kërkojnë PS të anulojë vendimet për vetingun



Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili u kërkoi dje, ambasadorëve të BE-së dhe SHBA-ve që të shpëtojnë vetingun dhe të mos heshtin. Në një postim të tij në rrjetin social "Facebook", Vasili shkroi dje: "Për shkak të frikës së shkollëpaktit nga vetingu, qeveria e tij e vogël futi duart e mëdha te vetingu. Qeveria tashmë i kontrollon strukturat e vetingut, u jep personel dhe para aq sa do ajo, dhe me anë të Ministrisë së Drejtësisë u administron investimet dhe informacionet, pra u kontrollon gjithçka". "Ambasadorët Lu dhe Vlahutin ishin garantët e pavarësisë së plotë dhe të pakushtëzuar të vetingut. Si anëtar i Komisionit të Reformës në Drejtësi, personalisht e votova vetingun në atë kohë (kujtoj që vota ime bënte diferencën) vetëm pasi besova totalisht garancitë e plota që dy ambasadorët e nderuar Lu dhe Vlahutin që përfaqësojnë SHBA dhe BE më dhanë edhe mua personalisht", - theksoi Vasili.

"Lu dhe Vlahutin kanë sërish në duart e tyre një mundësi të fundit që ta shpëtojnë vetingun, që zemra e reformës në drejtësi të mos pushojë ende pa filluar mirë dhe që shqiptarët të mos zhgënjehen përfundimisht. Le t'i kërkojnë mazhorancës t'i anulojë vendimet e fundit të marra në Kuvend me 73 vota duke asgjësuar të gjitha garancitë që vetë ambasadorët i dhanë të gjithë shqiptarëve në korrikun e 2016-ës", - u shpreh Vasili.



## Pagat e "vetingut", Ferhati: Komisionerët publikë do të marrin mbi 3 milionë lekë

Deputetja e PS-së, relatorja për organet e rivlerësimit të vetingut në Komisionin e Ligjeve, Klotilda Ferhati, foli dje për shkurtimet që iu bënë organikës së institucioneve të reja të vetingut. Në studion e emisionit "Kjo javë", me gazetaren Nisida Tufa në "News24", Ferhati tha se nga strukturat e organeve të vetingut nuk janë bërë shkurtime që prekin përmbajtjen e këtyre organeve. "Është riorganizuar pjesa e shërbimeve mbështetëse, administrative, ku janë hequr nga këto struktura një numër shoferësh. Ato po u jepen si shërbime Gardës së Republikës, pasi këtyre anëtarëve të organeve të vetingut u garantohet edhe siguria. Rreth 22 shoferë kanë ikur nga këto struktura, dhe do të jepen te Garda. Pra janë zhvendosur. Pjesa tjetër e stafit të shkurtuar, pasi ne miratuam 113 punonjës në total nga 185 që u kërkuan, pjesa tjetër ka të bëjë me rikonceptim të funksioneve mbështetëse, që kanë të bëjnë me shërbime, financë, sekretari, protokoll, të cilat janë rikonceptuar si shërbime. Pra të mos kemi struktura të fryra", - tha Ferhati. Duke folur për pagat, ajo pohoi se "për komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe për komisionerët publikë është rreth 3 mln e ca lekë, pasi ata marrin pagën e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ndërsa për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është diçka më shumë, mbi 3.2 mln lekë të vjetra, sepse kjo pagë llogaritet duke iu referuar pagës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese". E pyetur në lidhje me akuzat e kryetares së LSI-së se drejtësia është e kapur, Ferhati tha se "argumenti i kapjes së drejtësisë, më duket argumenti më qesharak për strukturën e vetingut".


PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

**Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj** zhvillon ankandin e dyte per shitjen e pasurise se paluajtshme "Njesi", me Nr.Pasurie 37/3-N25, Zona Kadastrale 2884, Vol.8, Faqe 27, me siperfaqe totale 551.14 m², te ndodhur ne Paskuqan, Tirane, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit ProCredit Bank Sh.a., per shumen 18'467'010.07 (tetembedhjete milion e katerqind e gjashtedhjete e shtate mije e dhjete pike zero shtate) Leke. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i dyte per shitjen e pasurise se paluajteshme është ne shumen 20,738,957.12 (njezete milion e shtateqind e tridhjete e tete mije e nenteqind e pesedhjete e shtate, pike dymbedhjete) leke.

Ankandi zhvillohet ne date 09.10.2017, ora 16.00 ne zyren e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, rruga Abdi Toptani, qendra Torre Drin, kt.2,nr.33,Tirane, dhe per informacion mund te kontakton ne nr.0682099471, 0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

**Studio Permbarimore "SHKRELA" do te zhvilloje Ankandin e pare per pasurite:**
**a)** "Njesi" me siperfaqe 40 m2, me nr. Pasurie 3/39-N5, Vol. 39, Fq. 21, Zona Kadastrale 8561, e ndodhur ne Lagjia nr.18, Korce, ne pronesi te bashkepronarve Spahi.
Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 31,360 (tridhjete e nje mije e treqind e gjashtedhjete) Euro.

**b)** "Apartament" me siperfaqe 83 m2, me nr. Pasurie 6/147+1-12, Vol.12, Fq.111, Zona Kadastrale 8581, e ndodhur ne Rr. Deshmoret e Pojskes, Pogradec, ne pronesi te bashkepronarve Spahi.
Cmimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 33,864 (tridhjete e tre mije e teteqind e gjashtedhjete e kater) Euro.
**Ankandi i pare zhvillohet me date 03.10.2017, ora 16.00 ne ambientet e Studios Permbarimore Shkrela me Adrese:Rruga Blv."Zogu i I", Pall. "Agimi", H 2, K 3, Ap. 5, Tirane.**

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :**

1- **"Apartament"** dublex, me sip. 449.6 m², Nr. Pas. 3/241+1-25, Volum.18, Faqe.211, ZK 8250, e ndodhur ne Rruga "N. Lena", hyrja 1, Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **339.897 Euro**. Ankandi do te zhvillohet **datë 18.10.2017 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane.

2- **"Magazine"** Nr.3, Kati i dyte, me sip. 703.55 m², Nr. Pas. 4/208-ND-N3, Vol.30, Fq.116, ZK 8514, e ndodhur ne Rr Skenderbej/4, Durres. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **327,600 Euro**. Ankandi do te zhvillohet **datë 09.10.2017 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane.

**Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al**

### Nënkryetari i PD-së: Basha u shtriu dorën e bashkëpunimit kundërshtarëve

# Paloka: Sulmi ndaj opozitës i shërben Ramës. I dëmshëm



Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka është kundër idesë së krijimit të fraksioneve në parti. Ai thotë se lëvizje të tilla janë të dëmshme për partinë, por thekson se janë të mirëpritura idetë dhe platformat që synojnë ringritjen e partisë, apo japin ide për ta sjellë atë në pushtet. Në emisionin "Kjo javë", me gazetaren Nisida Tufa në "News24", deputeti demokrat tha se Basha u shtriu dorën edhe kritikëve duke i ftuar të japin ide në funksion të qëllimit të përbashkët të PD-së, fuqizimit të partisë, dhe luftën ndaj fenomeneve që dëmtojnë vendin, si dhe për t'u bërë kundër kundërshtarit të vetëm, që sipas tij është aleanca e

**JOZEFINA TOPALLI**
Ish-deputetja e PD-së tha dje, se Lulzim Basha ka marrë peng siglën e Partisë Demokratike. "Po të donte z. Berisha ta hiqte Lulin nga kreu i kësaj partie, kjo do të ndodhte brenda 24 orëve. Ai nuk e bën këtë, sepse Berisha kur dha dorëheqjen tha që 'betejat e mia kanë mbaruar'", - u shpreh ajo.

krimit e Edi Ramës. "Flitet për fraksione të cilat synojnë marrjen e partisë, jo dhënien e ideve. Ka rryma në çdo parti që funksionon në këtë mënyrë, ka fraksione apo rryma, se mund t'i quajmë si të duam, por ndahen në aspektin e tyre ideologjik. Ka edhe në parti amerikane, njerëz me bindje më liberale apo konservatore. Dhe këto ndahen pastaj në çështje parimore. Janë të gjitha ide të pranueshme, pasi dikush mund të ketë ide për mënyrë sesi të vihet në pushtet, apo për qeverisje", - u shpreh dje Paloka. "Por, - shtoi ai, - nëse ngrihen fraksione me qëllimin që të marrin partinë apo lëvizje kundër kryetarit të partisë..." I pyetur në lidhje me lëvizjen e paralajmëruar nga Astrit Patozi, Paloka tha: "Unë s'kam parë as lëvizje, asgjë për momentin, di që ka disa kundërshtarë të Bashës që kanë dalë hapur dhe publikisht. Kjo është e vërtetë, dhe unë këtë e quaj të dëmshme. Në qoftë se ti nisesh thjesht me qëllimin që do krijoj tani një grupim brenda partisë vetëm për të luftuar Bashën, apo këdo tjetër, qoftë me qëllimin e vetëm që të marr unë drejtimin e partisë, atëherë kjo është e dëmshme". "Po lufta kundër Bashës nuk është thjesht kundër një individi, Basha përfaqëson PD-në, për mirë apo për keq, duam apo s'duam, me kontestime apo jo. Është bërë një proces zgjedhor dhe ka marrë votat e shumicës së demokratëve, dhe të vazhdosh të thuash sot se 'unë do vazhdoj të bëj luftë kundër Bashës', kjo e dëmton PD", - u shpreh nënkryetari i Kuvendit.

### Mblidhet parlamenti i parë rural, Ruçi: Dinamikë e re dhe zhvillim më i mirë për fshatin

# Mirditorja "përlot" Kuvendin: Duam ujë e rrugë

## *Peleshi: BE ofron 71 mln euro, ndërsa qeveria 23 mln*

Problemet e fshatit për herë të parë u ngritën me tone të forta dje, në Kuvendin e Shqipërisë. Nën kujdesin e kreut të Kuvendit, Gramoz Ruçi, u mbajt dje në sallën e seancave plenare sesioni përmbyllës i Parlamentit të Parë Rural Shqiptar, i cili zhvilloi punimet në datat 28-30 shtator në Tiranë. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Niko Peleshi, anëtarë të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, përfaqësuesi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, Stephen Stork. Por ajo që mori vëmendje më të madhe mediatike dje, por edhe në sallë, ishte blegtorja nga Mirdita, Rigerta Loku, e cila kërkoi përmes emocionesh investime për fshatin. Ajo ka mbaruar studimet e larta në Romë, në një nga universitetet më të mira në Itali, "La Sapienza", si dhe master shkencor për marrëdhënie ndërkombëtare me rezultate shumë të mira dhe u kthye në Shqipëri në provincën e saj, ku u gjend duke administruar një tufë dhish prej 350 krerësh. Ajo tha se nuk ishte penduar për këtë, por shtoi mes të tjerash: "Fshati ka nevojë të rilindë, rimëkëmbet, rianimohet. Le ta quajmë si të doni, fshati ka nevojë për kapital njerëzor, t'i shembim rrugët e braktisjes dhe të ndërtojmë rrugët e rikthimit". "Le të vishemi bukur sa të duam, të prodhojmë kë-


Rigerta Loku

pucë, biçikleta, industri, makina, avionë, sa të duam ne, por pa fshat të zhvilluar nuk ka qytete të zhvilluara. Po nuk na zhvilluat ne, ju nuk zhvilloheni kurrë! Zhvillimi i vjen Shqipërisë nga periferia! Atje nga Mirdita ime zhvillohet Tirana juaj dhe jo nga Tirana juaj zhvillohet Mirdita ime!" - u shpreh Loku, e cila përloti edhe përfaqësuesin e BE-së. Duke folur edhe për bashkëfshataren e saj me emrin Kristina, që "ngrihet para diellit dhe ulet shumë pas tij", Loku tha se ajo fshatarja atje do ujë dhe rrugë, por edhe shkolla e qendër shëndetësore. Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi tha: "Prioritetet e punës suaj përkojnë edhe me programin e qeverisë së re, ndaj dhe Komisioni Parlamentar i Veprimtarisë Prodhuese, Mjedisit dhe Tregtisë, i cili ndodhet sot i ftuar në këtë aktivitet, shpreh besimin se do ta ketë këtë në qendër të vëmendjes për një vlerësim të vazhdueshëm mbi rezultatet e saj. M'u duk me shumë interes edhe ideja e centralizimit të parlamentit rural. Kjo do të krijojë një dinamikë të re, duke nxitur bashkëpunimin sipas prioriteteve të vendit, për një zhvillim më të mirë". Përfaqësuesi i sektori të BE-së, Stephen Stork vlerësoi nismë e Parlamentit të Parë Rural, duke e konsideruar atë si një mundësi shumë e mirë për të gjeneruar ide për zhvillimin e sektorit bujqësor në Shqipëri. "Potenciali i këtij sektori është ende i pashfrytëzuar plotësisht, pasi vetëm 20% e Prodhimit të Brendshëm Bruto gjenerohet nga bujqësia", - tha Stork. Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Niko Peleshi në fjalën e tij tha se BE-ja ka ofruar 71 milionë euro për zhvillimin rural, ndërsa qeveria shqiptare rreth 23 milionë euro. "Bëmë shumë gabime në këto vite. Tokën e parcelizuan dhe e bënë konsolidimin e tokës një nga sfidat më të mëdha. Të gjitha këto ishin vendimmarrje të të gjithë aktorëve së bashku me në krye politikë. E megjithëse bëmë shumë gabime, bujqësia mban flamurin e Zhvillimit", - tha Peleshi.

**NARD NDOKA**
"Kristina nga Mirdita kërkon rrugë e ujë, por Rama kërkoi tepsi dhe timon! Rigerta nga 'La Sapienza' kërkon politika zhvillimi për fshatin, por Rama do të 'rilindë' sheshet e fshatrave duke i shtruar me pllaka! Tjetër kërkon Rigerta, tjetër ka bërë dhe do bëjë Rama!", tha dje, Nard Ndoka.



### Kryetarja e LSI, në panairin bujqësor në Përrenjas

## Kryemadhi: Sa më shumë prodhim vendas, aq më e fortë ekonomia

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi ishte dje, në Bashkinë e Përrenjasit, ku mori pjesë në Panairin e Produkteve Bujqësore të zonës. Në fjalën e saj në këtë panair, Kryetarja e LSI-së u shpreh para fermerëve: "Të jemi sa më pranë jush për të diskutuar dhe ngritur problemet që çdo ditë e më shumë të lehtësojmë prodhimin dhe të rrisim sa më shumë prodhimin vendas. Sa më shumë prodhimin vendas të kemi, aq më e fortë është ekonomia jonë, sa më e fortë të jetë ekonomia juaj, aq më shumë zhvillohet bashkia juaj, aq më shumë kanë mundësi fëmijët tuaj për të jetuar më mirë, më të lumtur dhe më të begatë në vendin tonë". Sipas saj, "ajo çka ofron Shqipëria është një nga mundësitë më të mëdha që kemi për zhvillimin e produkteve tona, të cilat të mos jenë të konsumueshme vetëm brenda vendit por edhe jashtë saj. Sigurisht që perspektivat janë shumë të mira, por me një organizim shumë të mirë, me një përkrahje shumë të mirë që mund të bëhet qoftë nga Bashkia, qoftë nga institucionet shtetërore, nga qeveria, do të zhvillonte akoma më tej këtë bujqësi". Kryemadhi shtoi se zhvillimi duhet parë edhe në aspektet e tjera, siç është etnografia, aspekt të cilin zona e Rrajcës e ka mjaft të zhvilluar, duke pasur parasysh kostumet e mrekullueshme të zonës.

**Shoqëria përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k**
**shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:**

*Pasurisë me Nr.14/39 e llojit truall+ndërtesë me sip. 115 m², me sip. ndërtese 95 m² ndodhur* ***në Lagjen "Kushtrim",*** *ZK. Nr.8503 Berat,* në pronësi të **Bledar Xhemal Shtembari.** Çmimi fillestar në ankandin e tretë 1,480,317 lekë.

Ankandi zhvillohet në datë **11.10.2017, ditën e Mërkurë ora 15.30** në ambjentet e **Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "S. Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1,Tiranë. Për më shumë info.** Tel:044503458 **ose E-mali** shoqeriapermbarimoreafa2010@gmail.com

**Shoqëria përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k**
**shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:**

*Pasurisë me Nr.3/369 e llojit "Truall + Banesë 3 katëshe" me sip. trualli 350 m2 , dhe sip. banese 191.9 m2 . ( kati pwrdhe 191.9 m², kati i I.269.03 dhe katiII 269 m² ) ndodhur në L. "11 Janari", ZK. 2310, Kuçovë* ,në pronësi **Agim Isa Zequa**. Çmimi fillestar në ankandin e parë është 16,000,000 Lekë.

Ankandi zhvillohet në **datë 03.10.2017**, ditën e Martë ora 15.30 në ambjentet e **Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për info. Tel:044503458 ose E-mali shoqeriapermbarimoreafa2010@gmail.com**

**SHPALLJE ANKANDIT TE PARE**

Pasuria ne pronesi te **Shoqërise "Italconstruzioni Pistoia"shpk** me te dhenat : ZK.2460,Nr, regjistri hipotekor Lloji apartament me siperfaqe 72,53 m2, ap Nr.18 kati i 4 shk.1 seksioni 1
Ankandi mbyllet ne date **10.10.2017** cmimi i daljes ne ankand **26.111 euro**
**Adresa : Rr. Urani Pano, ndertesa 1/3 , Kati i 2 te Tirane**

NJOFTIM

Pranë zyres përmbarimore te shoq."**etebest**" shpk,adresa:Rr."D.Hoxha",nr.91/5, Tiranë, zhvillohet ankand I hapur në datën 11/10/2017, ora 15.30, Pasuritë ne shitje jane : 1.Pas.,truall me nr.70/6 ,Zk.1042;S=5447m2;Nr.regj.vol.11,fq 144,dhe pas. nr.70/4,ZK.1042;S=728 m2 Nr.regj.vol.11,fq.24, ,Zk.1042;S=5447m2 ", me adresë;fshati Arrameras ,Kruje.vlera fillestare =5508300L

Te interesuarit te paraqiten ne adresen: Rr."D.Hoxha" nr.91/5,Tirane. tlf.673019849; email:etebest@gmail.com.

Detaje si do të koordinohet puna e Tatimeve, Doganave dhe Inspektoratit të Punës

# Qytetarët që nuk tërheqin kuponin tatimor do të gjobiten

## *Faza III/ Nesër nis aksioni në terren kundër informalitetit*

Ornela Manjani

Sot nis aksionit "anti-in formaltitet III". Në fokus nuk do të jenë vetëm bizneset, por edhe konsumatorët. Çdo qytetar para se të dalë nga dyqani duhet të jetë i pajisur me kuponin tatimor. Në rast të kundër do të gjobitet me 1 mijë lekë. Inspektorët tatimorë do të dalin në terren dhe do të presin blerësit për të verifikuar marrjen e kuponit. Skema bëhet e ditur nga burime zyrtare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilat bëjnë të ditur se duke filluar nga 1 tetori, kur nis dhe faza e tretë anti-informalitet nuk duhet të bëjnë kujdes vetëm bizneset, por edhe qytetarët. "Qytetarët do kontrollohen, kanë detyrim ligjor të tërheqin kuponin. Në momentin që qytetarët nuk e tërheqin kuponin sigurisht që ka dhe penalitet që është 1 mijë lekë për ata që thyejnë ligjin. Ne do i inkurajojmë të jenë pjesë e këtij aksioni. Jo gjithmonë do hyjmë direkt në ambientin e biznesit, por do pyesim një qytetar që sapo ka marrë një shërbim në atë njësi, i cili më tej mund të jetë dhe objekt i kontrollit. Janë skema që përdoren në gjithë botën, ka punonjës të administratës tatimore, por jo vetëm, që hyjnë në një aktivitet. Qëllimi është jo të penalizojmë qytetarin, por të jetë pjesë e aksionit dhe palë me administratën tatimore",-bëjnë të ditur burimet zyrtare nga tatimet.

**AKSIONI**

Aksioni kundër informalitetit "zbret" në terren ditën e nesërme, më 1 tetor. Lajmi u dha pak ditë më parë nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë, Arben Ahmetaj, i cili deklaroi se do të ketë një koordinim nga të gjitha strukturat si Tatimet, Doganat dhe Inspektorati i Punës. "Nga data 1 tetor 2017 fillojmë aksionin në terren.



Foto ilustruese

Ky është mandati i anti-informalitetit, do të kemi koordinim të të gjithë strukturave: Tatimet, Doganat dhe Inspektorati i Punës. Krahas aksionit kundër informalitetit, ndërmarrim një tjetër reformë të rëndësishme për lehtësimin e shërbimeve dhe reduktimin e burokracisë për sipërmarrjen dhe qytetarët", u shpreh Ahmetaj pak ditë më parë. Strukturat në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Inspektorati i Punës do të organizohen në grupe të përbashkëta, të orientuara nga analiza e profileve të riskut të sektorëve dhe bizneseve brenda tyre, duke pasur në fokus të gjithë zinxhirin e transaksioneve nga biznesi i madh deri te konsumatori final. Punësimi e siguria në punë do të kenë një vëmendje të posaçme brenda aksionit. Po kështu pak ditë më parë në një letër drejtuar sipërmarrësve, Ahmetaj thoshte se së shpejti do të prezantojë edhe planin e masave për vazhdimin e betejës kundër informalitetit në ekonomi, duke shtuar se qeveria do të këmbëngulë në zbatueshmërinë e ligjit, për garantimin e rregullave të drejta e të barabarta në një treg të hapur e konkurrues. Në këtë letër, Ahmetaj deklaroi, gjithashtu, se qeveria do të ndërmarrë një reformë në favor të sipërmarrjes për rregullimin e tregut përmes reduktimit të numrit të lejeve/licencave dhe autorizimeve, si dhe dokumenteve që kërkohen nga zyrat e shtetit për përfitimin e një shërbimi apo një të drejte. "Angazhimi ynë në këtë drejtim, vijon edhe me një tjetër reformë thelbësore në favor të sipërmarrjes dhe rregullimin e tregut përmes reduktimit të numrit të lejeve/licencave dhe autorizimeve, si dhe dokumenteve që kërkohen nga zyrat e shtetit për përfitimin e një shërbimi apo të drejte", thuhej në letër.

albpetrol

**NJOFTIMI I ANKANDIT**

1. **Autoriteti shites:** Albpetrol sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7
2. **Data e zhvillimit te ankandit:** 03/10/2017
3. **Lloji i Procedurës standarde te ankandit:** Procedure e hapur
4. **Objekti i Shitjes:** Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 $Nm^3$
5. **Afati i evadimit:** 600 000 $Nm^3$ brenda 1 viti nga data e nenshkrimit te kontrates dhe 3 000 000 $Nm^3$ brenda 5 viteve nga data e nenshkrimit te kontrates.
6. **Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes**: Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 $Nm^3$, gaz i prodhuar ne vendburimin Cakran Mollaj.
7. **Vlera fillestare:**

   **Cmimi= 0,8 x TTF + K**

   - TTF eshte cmimi ne euro/mwh i gazit shoqerues te publikuar ne bursen hollandeze.
   - K- eshte vlera euro/mwh e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal te shitjes te perllogaritur nga formula (Ke"0).
   - Per konvertimin e cmimit nga euro/mwh ne euro/$Nm^3$ per gazin e vendburimit Cakran Mollaj do te perdoret koeficenti 0.00781.
8. **Vendndodhja e gazit shoqerues: Albpetrol sha Patos** Vendburimi Cakran Mollaj
9. **Vendi i zhvillimit te ankandit:** Ministria e Energjise dhe Industrise, Sheshi Skenderbej, Tirane, salla e mbledhjeve kati I-re.
10. **Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: ne zyren e protokollit te Ministrise se Energjise dhe Industrise, datë 03/10/2017, ora 11:00**
11. **Informacion mbi dokumentet e ankandit:** Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites me paraqitjen e nje kerkese me shkrim ose ne faqen zyrtare te "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe ne faqen e Ministrise se Energjise dhe Industrise www.energjia.gov.al.

   Dokumente me pagesë:

   Po ☐ Jo X
12. **Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, perpara dates dhe ores se zhvillimit te ankandit, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.**

Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia: Rruga Fier-Patos Km. 7 Patos /Tiranë, Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Pallati Sky Tower
**T** +3553813662 **F** +35534704415 **w** www.albpetrol.al

### Rreziku nga vendimet, shofer personal për secilin

# Garda e Republikës merr në mbrojtje 27 anëtarët e organeve të vetingut



Garda e Republikës së Shqipërisë

Merren në mbrojtje nga Garda e Republikës 27 anëtarët e organeve të vetingut, të cilët do të kryejnë verifikimet për 750 gjyqtarët dhe prokurorët. Ky verifikim konsiston në: Përjashtimin nga sistemi i drejtësisë i gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët nuk justifikojnë dot me dokumentacion ligjor pasuritë që posedojnë, rezultojnë me lidhje të papërshtatshme me krimin apo janë të paaftë profesionalisht. Komisioni i Ligjeve ka përgatitur një raport ku reflektohet vendimi dhe sqarohen edhe prapaskenat e uljes me 40 % të stafit të vetingut. "Është gjykuar nevoja për ofrimin e mbrojtjes së veçantë, nga personeli i Gardës së Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin e saj organik. Në këtë kuptim personeli i Gardës së Republikës së Shqipërisë do të ofrojë jo vetëm mbrojtjen e posaçme, por do të sigurojë edhe shërbimin e transportit për anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në përputhje me këtë arsyetim, në variantin e rishikuar është rikonceptuar propozimi për pajisjen me shoferë", thuhet në raport. Kjo zgjidhje vjen pasi organet e vetingut kanë kërkuar shofer personal për çdo anëtar. Gjithashtu, anëtarët e Komisionit të Rivlerësimit kanë depozituar në Kuvend një projektvendim ku shprehen se do të përballen me presione për shkak të punës së tyre dhe se ata dhe familjet e tyre do të jenë në rrezik. Arsye kjo që i çoi anëtarët e katër Komisioneve të Rivlerësimit të bëjnë kërkesën për shpërblimin mujor për vështirësi.

> **RAPORTI**
> "Personeli i Gardës së Republikës së Shqipërisë do të ofrojë jo vetëm mbrojtjen e posaçme, por do të sigurojë edhe shërbimin e transportit për anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në përputhje me këtë arsyetim, në variantin e rishikuar është rikonceptuar propozimin për pajisjen me shoferë".

### 3 nga të lënduarit në polici: Ishim rastësisht në vendngjarje

# Plagosja e katërfishtë në Laprakë, Leka: S'e dija që sherri do arrinte në këtë pikë

## Pronari i lokalit: Ja si u konfliktova me vëllezërit Seferi

Ina Allkanjari





Vendi ku ndodhi ngjarja

Zbardhet dëshmia e Elion Lekës, personi i cili mbeti i plagosur nga atentati i ndodhur mbrëmjen e së premtes në një lokal në "Laprakë". I pyetur nga uniformat blu, Elion Leka, i cili ishte edhe objektivi i atentatit, tregoi se një ditë përpara ka pasur një konflikt me vëllain e Arben Seferit, Astrit Seferin. Ai rrëfeu se të enjten pasdite, ka debatuar me Arben Seferin, por ishte një sherr i momentit. Sipas dëshmisë së Elion Lekës, i cili është edhe pronari i lokalit, vetëm gjysmë ore përpara atentatit, vëllezërit Seferi janë rishfaqur sërish dhe kanë debatuar me atë, por Leka tha që nuk e dija se konflikti do degradonte deri në këtë pikë. 31-vjeçari tregoi se dy vëllezërit u afruan dhe hapën zjarr drejt tij në mënyrë të menjëhershme, në momentin kur ai ndodhej në ambientin e jashtëm të lokalit. Leka rrëfen se vrapoi për t'u fshehur poshtë banakut, por ndërkohë një nga plumbat e kishte plagosur në krah. Bashkë me Lekën në të njëjtën ngjarje, u plagosën edhe Avni Biberi 46 vjeç, Bujar Mrishaj 31 vjeç e Bledar Gosturani 33 vjeç. Tre të plagosurit e tjerë të pyetur nga policia pohuan se nuk kishin dijeni mbi konfliktet e Lekës me dy vëllezërit Seferi dhe në momentin e ngjarjes, ata kanë qenë të ulur jashtë lokalit. Mësohet se pas atentatit autorët u larguan me një automjet në drejtim të rrugës "Gjergj Legisi", në Laprakë dhe janë ende në kërkim. Sipas policisë, objektivi ka qenë Elion Leka, por gjatë atentatin mbetën të plagosur edhe 3 klientë të këtij lokali.

**NGJARJA**

Katër persona kanë mbetur të plagosur me armë zjarri në një lokal në kryeqytet, mbrëmjen e së premtes, pas një sherri momenti. Janë shpallur në kërkim dy vëllezër, të dyshuar si autorë të atentatit. Ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 18:30 minuta, në rrugën "Gjergj Legisi", në zonën e Laprakës. Burime pranë policisë bënë me dije se të plagosur kanë mbetur shtetasit Elion Leka, 31 vjeç, B.M, 31 vjeç, B.K, 33 vjeç dhe A.B, 46 vjeç. Të plagosurit u dërguan menjëherë në Spitalin e Traumës dhe fatmirësisht ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Burimet e lartpërmendura sqaruan se janë shpallur dy shtetasit Astrit dhe Arben Seferi. Ky i fundit mësohet se mesditën e së enjtes ishte përfshirë në një konflikt me 31-vjeçarin. Pasditen e së premtes, ai kishte shkuar përballë lokalit të Lekaj dhe prej andej qëlloi me armë zjarri pistoletë, ku mbeti i plagosur pronari i lokalit, 31-vjeçari Lekaj si dhe tre klientët që ndodheshin rastësisht aty. Pas kësaj, Arben Seferi është ndihmuar nga i vëllai për t'u larguar prej andej. Menjëherë, policia mbërriti në lokalin ku ndodhi ngjarja dhe filloi hetimin për zbardhjen e plotë të rrethanave, ndërsa u ngritën pika të shumta kontrolli për të bërë të mundur arrestimin e dy vëllezërve. Mendohet se konflikti mes dy palëve ka nisur për motive të dobëta. Dyshimet e policisë janë se ata mund të jenë ndihmuar nga ndonjë person i tretë dhe se mund të jetë larguar në drejtim të qytetit të Durrësit, apo edhe në zonën e Fushë-Krujës. Operacioni për kapjen e autorit të krimit dhe bashkëpunëtorëve të tij po drejtohej nga drejtori i policisë së Tiranë, Ardi Veliu, i cili shkoi menjëherë në vendin ku ndodhi plagosja. Prej aty, në një prononcim për mediat, Veliu tha se kanë identifikuar dy autorët e krimit dhe janë vënë në ndjekje të tyre.

> **DYSHIMI**
> Mendohet se konflikti mes dy palëve ka nisur për motive të dobëta. Dyshimet e policisë janë se ata mund të jenë ndihmuar nga ndonjë person i tretë dhe se mund të jetë larguar në drejtim të qytetit të Durrësit, apo edhe në zonën e Fushë-Krujës. Operacioni për kapjen e autorit të krimit dhe bashkëpunëtorëve të tij po drejtohej nga drejtori i policisë së Tiranës, Ardi Veliu, i cili shkoi menjëherë në vendin ku ndodhi plagosja.

## SHKURT

### Arrestohet 25-vjeçari, lëvizte me pistoletë dhe motor pa dokumentacion

Një 25-vjeçar ka rënë në pranga ditën e premte në Tiranë, pasi u kap nga policia duke lëvizur me një armë zjarri dhe motor të pa pajisur me dokumentacion. Bruno Kurti, banues në Tiranë, u arrestua nga skuadra "Shigjeta" në rrugën "Bardhyl" duke qarkulluar me motor pa dokumentacionin përkatës. Gjatë kontrollit fizik të ushtruar është gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri "Browing", me një krehër me fishekë. Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar në banesë janë gjetur dhe sekuestruar: një silenciator, një palë dylbi, 21 copë fishekë, 5 telefona, një qese farmacie me lëndë të dyshuar narkotike të llojit cannabis sativa, një thikë me palosje, një thikë me dorezë të zezë, shkop gome, 2 shkopinj të punuar në mënyrë artizanale, 6 targa automjetesh, një kartëmonedhë 2000 e dyshuar false, një minikartë telefoni dhe prozhektor. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Tiranë në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprat penale "Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik", "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit" dhe "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

### Bie në pranga 45-vjeçari, u kap me 1301 steka cigaresh kontrabandë

Arrestohet 45-vjeçari Dashamir Ymeri, pasi i janë zbuluar 1301 steka cigare kontrabandë gjatë operacionit policor të koduar "Smoking kills". Dashamir Ymeri, banues në Tiranë, bënte kontrabandë cigaresh nga Maqedonia, drejt Shqipërisë. Gjatë kontrollit në banesën e tij në rrugën "Kujtim Laro", i janë gjetur dhe sekuestruar 27.200 euro dhe 55 dollarë, të cilat dyshohet se janë përfituar nga kontrabanda e cigareve. Krimi Ekonomik në policinë e Tiranës në bashkëpunim me Drejtorinë e Doganave kanë zbuluar kalimin e 1301 steka cigaresh kontrabandë. Mësohet se 45-vjeçari ka qenë dhe më parë i dënuar për kontrabandë. Gjithashtu, u procedua në gjendje të lirë edhe një shitës ambulant, shtetasi Rr.Sh., i cili i merrte cigaret dhe i shiste. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të shtetasit D.Y., për veprat penale "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë", "Fshehje të ardhurave" dhe "Shkelje pronësisë industriale". Ndërsa për shtetasin Rr.Sh., për veprën penale "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë".

Të riatdhesuarit përfundimisht, më shumë lehtësira, ja dokumentacioni që duhet dorëzuar

# Italia, pensione për shqiptarët

## *Drejtuesja e "Inas Albania": Përfitohet mbi moshën 66,7 vjeç*

Voltiza Duro



Beskida Aliaj



Të gjithë emigrantët shqiptarë që kanë jetuar e punuar në Itali mund të përfitojnë pension nga shteti fqinj, në momentin që përmbushin kriteret e nevojshme. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Beskida Aliaj, drejtuesja e "Inas Albania", njëkohësisht përfaqësuese e degës "Patronato INAS Cisl Albania", tregon të gjithë hapat që duhen ndjekur për të përfituar pension nga shteti italian. Ajo bën me dije se, sipas ligjit italian, në rast riatdhesimi përfundimtar, shqiptarët që kanë punuar në vendin fqinj, mund të përfitojnë pension bazuar në dy mënyrat e përllogaritjes, sipas sistemit kontributiv dhe atij retributiv. Kriteri i parë për të përfituar pension është mosha 66 vjeç e 7 muaj, ndërsa kriteri i dytë është minimum 5 vite kontribute. Aliaj shpjegon për të gjithë të interesuarit rrugën institucionale që duhet të ndjekin për të marrë statusin e të riatdhesuarit dhe për të përfituar pension nga Italia.

**A mund të përfitojnë shqiptarët që kanë jetuar e punuar në Itali pension nga vendi fqinj?**

Emigrantët shqiptarë në Itali mund të përfitojnë pension nga vendi fqinj. Sipas ligjit italian, në rast riatdhesimi përfundimtar, punonjësi ekstrakomunitar me kontratë të ndryshme nga ajo sezonale, gëzon të drejtën për përfitimin nga sigurimet shoqërore, të maturuar në Itali, dhe përfiton të tilla të drejta, edhe kur nuk ekziston një marrëveshje reciproke me vendin e origjinës. Për sa u përket punonjësve ekstrakomunitarë të riatdhesuar, ata kanë disa favore dhe lehtësira, krahasuar me përfitimet e punonjësve rezidentë në Itali, duke reduktuar moshën për përfitime.

**Cilat janë kriteret për ta përfituar këtë pension?**

Punonjësit e siguruar deri në datën 31.12.1995, kanë të drejtën e daljes në pension në qoftë se mund të plotësojnë të paktën 20 vjet kontribute (1040 kontributet javore), dhe punonjësit e siguruar pas datës 31.12.1995, kanë të drejtën e daljes në pension në qoftë se ata mund të kenë jo më pak se 5 vjet kontribute (260 javë) dhe e përfitojnë pensionin në moshën 70 vjeç. Por, në rast se kandidati është regjistruar pranë INPS dhe ka paguar kontribute mbas datës 01.01.1996, në rast se merr statusin e të riatdhesuarit, përfiton pension me moshat zyrtare të daljes në pension në Itali, pa qenë domosdoshmëria e plotësimit të moshës 70 vjeç, me jo më pak se 5 vite kontributive. Aktualisht, mosha e daljes në pension për burrat është 66 vite e 7 muaj.

**MARRËVESHJA**

"Aktualisht janë mbi 500 mijë emigrantë në Itali. Nënshkrimi i një marrëveshjeje me shtetin fqinj do të sillte edhe më shumë përfitime për emigrantët shqiptarë, sepse do të mundësonte llogaritjen e viteve të kontributeve në të dyja vendet", - u shpreh drejtuesja e "Inas Albania".

**Si përllogaritet pensioni?**

At Zef Pllumi në vitet e fundit qëndronte tek një e mbesa e tij në një lagje tiranase. Krejt ndryshe nga miti urban dhe nga qasja që bëjnë sot shumë personazhe, apo nga njohjet që i atribuohen, ai preferonte vetminë, ku kishte mundësinë të bënte përsiatje për jetën e tij të vështirë, por edhe zhgënjimet e mëdha, që e ndoqën deri në fund. Ai prehet në paqen e fundme në varrezat françeskane te Kisha Zoja rruzare te Arra e Madhe në Shkodër, mu atje ku i gjenden edhe shumë të afërm dhe bashkëvuajtës. Me gjasa, vetëm n'at botë duket se gëzon paqtimin e vet sublim.

Në një udhëtim të stërgjatë vite më parë, teksa kërkoja famullinë e vjetër të At Gjeçovit, nëpër Gomsiqe, mu desh që veç banorëve të pyesja dhe shumë nga klerikët e asaj treve. Për fatin e keq, shumë prej tyre syresh ishin të huaj dhe jo vetëm nuk e kishin dëgjuar emrin e françeskanit të madh, por as nuk kishin interes të mësonin ndonjë gjë për të. Më keq, historia vazhdonte me banorët e atjeshëm. Në këto kushte iu drejtova At Zefit, ndodhte vetëm pak muaj para vdekjes, për të ditur koordinatat e mundshme të famullisë, që e përmend në kujtimet e veta Konica, teksa e viziton me At Fishtën. Nga matanë telefonit vinte një zë i lodhur, por kur i shpjegova mundimin, mu përgjigj thjesht: *"S'ke ça me prit nga t'hujt. Kshtu ndodh kur janë t'huaj, kush do me dit prej tyre për priftnijt shqiptar. E marre edhe për njerëzi aty, që nuk din gja. Ku ndodhesh tash? Ah... Po nëse merr rrugën poshtë dhe shkon n'prrue, do gjesh shenja...Merr..."*. E falenderova, pa ditur se ky do të ishte komunikimi i fundit. Pas pak kohësh e gjeta thjesht famullinë, tashmë e braktisur në zhavorrin e përroit, me shenja që tregonin pelegrinazhe të vogla dhe pak mbetje që konfirmonin objektin fetar.

Në fakt moskuptimet e tij me autoritetet françeskane nuk ishin të reja. Madje deklarata e tij: *"Po vuaj ma shumë në këto vite nga eprorët e mi sesa nga vitet që kam kaluar në burg"*, dihej qartë dhe flitej shpesh në qarqe françeskanësh. Por, e pakuptueshme për publikun ishte sesi një personazh i tillë, një legjendë, vazhdonte të ngacmohej dhe të lodhej nga superiorët e kishës françeskane. Një kuptim e ka: At Zefi ishte shumë kundër përhapjes së priftërinjve të huaj në vend dhe vazhdonte e predikonte përkorjen, bash atë që qëndron në thelb të urdhrit françeskan. Përqendrimi i tij më i madh do të ishte në përhapjen e kulturës të urdhrit dhe përcjelljen cilësore të saj. Rruga që predikonte ishte: të punonte në gjurmët e Fishtës, të arrinte të krijonte një shtypshkronjë për të sjellë me radhë veprat e françeskanëve të mëdhenj, por edhe të ngrinte të gjithë problematikën e klerit shqiptar në diktaturë, që të mos harrohej. Ai na la trashëgim një vepër e cila tregon shumë për kalvarin në komunizëm. Personalisht, vuri themelet Kishës së Shna Ndout Laç – Sebaste. Ndihmoi shumë për të gjetur referenca për trupin e të ndjerit Gjergj Fishta, ashtu si u përpoq shumë për problemet me të cilat hasej sot komuniteti i vet. Vite më parë, një klerik, që preferoi të mbetej anonim solli dokumente që tregonin se At Zefi nuk ishte aq i dashur për klerikët, madje ishte i izoluar nga të gjithë klerikët e ardhur si misionarë nga vendet e huaja, sidomos u refuzua nga klerikët italianë, qoftë nga klerikët e thjeshtë, qoftë nga eprorët dhe Prelatët e Kishës, të ardhur për të "ndihmuar".

→ Vijon në faqen 20

Në këtë numër: At Zef Pllumi, Shpëtim Çuçka për Dritëro Agollin, Moikom Zeqo, Sul Gragjevi, Vladimir Vujoviç etj...

Redaktor: Ben Andoni; Grafika Artan Buca 304

*Nga ky numër, "Milosao" po fillon botimin e një cikli të gjatë kushtuar poetit Dritëro Agolli, përgatitur nga Shpëtim Çuçka, përkthyes dhe publicist. Autori ka punuar për disa javë mbi figurën e personalitetit të njohur të letrave shqipe për ta paraqitur me të gjithë larmishmërinë e mundshme.*

A
ARGUMENT

# Dritëro Agollin e shpërfytyruan në ceremonialin e pasvdekjes

*Në mest tuaj kam qëndruar*
*E jam duke përvëluar,*
*Që t'u ap pakëzë dritë*
*Natënë t'ua bënj ditë.*

**(Naim Frashëri, "Fjalët e qiririt")**

NGA SHPËTIM ÇUÇKA*

1.

Po afrohet i pari përvjetor lindjeje, që nuk e gjen në jetë Dritëro Agollin. Ky është rasti, kur veprimtaria e njeriut, pikërisht për shkak të mungesës së tij, mund të shihet pa mbingarkesa emocionale, pra, pa errësim të ndërgjegjes vëzhguese nga ndjenjat.

Kjo nuk do të thotë se objektiviteti i ftohtë është mënyra më e përshtatshme për të arritur tek e vërteta. Kërkimi i së vërtetës ka qenë kurdoherë çështje vullneti, dëshire, pasioni. Sikurse edhe klime shoqërore. Që e vërteta të zbulohet, duhet që kërkuesi ta dëshirojë një gjë të tillë. Që të vërteta të caktuara të zbulohen, kërkuesit i duhet mbështetja e shoqërisë. Në historinë e njerëzimit veprimtaria për gjurmimin dhe zbulimin e së vërtetës, jo vetëm rreth natyrës por edhe e sidomos rreth shoqërisë, ka qenë – duke përjashtuar këtu periudha të vogla – jo thjesht e rrethuar nga një klimë mospërkrahjeje, por edhe diçka në thelb e ndaluar dhe me rrezik për jetën.

Objektiviteti i vështrimit të një teme a çështjeje nuk e përjashton aspak parashtrimin me ndjenjë – ndjenjë dashamirëse ndaj objektit ose armiqësore ndaj tij – të përfundimeve të vëzhgimit. Shkenca, domethënë dija e saktë, dija e së vërtetës, e parakupton ndjenjën, pasi e vërteta për shkencëtarin është jo thjesht e nevojshme, por sidomos e dëshiruar, e dashur. Shkencëtari, si kërkues i së vërtetës, priret drejt saj, anon nga ajo, ka etje për të, duke iu kundërvënë të pavërtetës. Shkurt, kush e synon dhe e kërkon të vërtetën, nuk mund të jetë shpërfillës dhe i pandjeshëm as ndaj së pavërtetës. Miku i së vërtetës është edhe armik i së pavërtetës.

2.

Dëshmia më e afërt në kohë për ne e mungesës së klimës shoqërore për gjurmimin e së vërtetës është pikërisht periudha e sotme, periudhë e ashtuquajtur e demokracisë. Dhe qëndrimi ndaj Dritëro Agollit dhe veprës së tij përbën një ndër rastet më tipike të shfaqjes së kësaj klime shoqërore kundër së vërtetës.

E vërteta mbi figurën e Dritëro Agollit dhe rolin e tij në letërsinë, kulturën dhe historinë e Shqipërisë, nuk mund të dalë në pah pa vullnetin e nevojshëm, pa dëshirën e qartë për ta gjurmuar me ndershmëri, domethënë në mënyrë rreptësisht shkencore, këtë të vërtetë dhe për ta pasqyruar atë ashtu si shfaqet pas hulumtimit serioz, madje për ta shpalosur në mënyrë të hijshme, ashtu siç e meriton e vërteta.

Kur i drejtohemi veprimtarisë shoqërore dhe krijimtarisë letrare të Dritëro Agollit, ne nuk mund të shmangim qëndrimin tonë ndaj gjithçkaje që ka të bëjë me to. Ne, madje, në pjesën më të madhe të rasteve ndikohemi pikërisht nga formimi ynë, nga bindjet tona dhe nga prirjet tona subjektive, që përcaktojnë në tërësi qëndrimet tona shoqërore. Në njëfarë kuptimi ne nisemi më së shumti nga shijet tona ose, thënë disi më ndryshe dhe në mënyrë më të përgjithësuar, nga shija jonë vetjake.

Por, kur shohim veprimtarinë e Dritëro Agollit, ne ndikohemi më së shumti edhe nga klima e përgjithshme shoqërore, në të cilën ndodhemi, nga bindjet dhe prirjet mbizotëruese shoqërore të kësaj kohe, nga shijet mbizotëruese të shoqërisë ose, për ngjashmëri me sa më sipër, nga shija mbizotëruese e shoqërisë, nga moda e kohës.

3.

Është e nevojshme të sqarohet diçka, kur flasim për bindje e prirje mbizotëruese shoqërore, për shije e për modë. Nocioni "mbizotërim" këtu nuk duhet kuptuar sikur tregon për shtrirjen e tij në masën e qytetarëve të vendit, për përqafimin e tij nga shumica dërrmuese.

Një pjesë e banorëve të vendit tonë ka kohë që e ka humbur shprehinë e të interesuarit për dukuritë e kulturës dhe të artit. Kjo thjesht për arsye ekonomike, nga shtrëngesa e rëndë për të siguruar mjetet ngushtësisht të nevojshme për jetesë.

Një pjesë tjetër qytetarësh e ka pak a shumë të qartë karakterin e dhunshëm – në formë e përmbajtje – të asaj, që na jepet, dhe e tregon mospranimin e kësaj dhune duke kufizuar ose ndërprerë plotësisht kontaktin me një produkt të tillë gjojakulturor, të huaj a imitues të së huajës, i cili na jepet në mënyrë të përditshme e paturpësisht ngulmuese dhe përbën një thyerje të egër me traditën kulturore e morale të shumicës së popullsisë, në fakt përbën një shkatërrim të qëllimshëm, pra, fajtor, të kësaj tradite.

Natyrisht ka edhe një pjesë qytetarësh, që bien pre e propagandës bombarduese të bindjeve, prirjeve, shijeve, dhe e përqafojnë këtë modë, në kuptimin e gjerë të kësaj fjale.

Së fundi, ka edhe një shtresë të vogël, e cila ka marrë përsipër – për bindje a pagesë, kjo nuk ka rëndësi – ta kryejë këtë propagandë bombarduese dhe në fakt është shndërruar në bartëse të gjojavlerave mbizotëruese. Kjo shtresë të kujton ata rrobaqepësit në përrallën emblematike të Andersenit, të cilët qepnin petkat e padukshme (sepse të paqena) të mbretit, si dhe shtresën e oborrtarëve, të cilët për të mos u dukur si budallenj hiqeshin sikur i shihnin ato petka.

Sot ne jemi pikërisht në një kohë dhe në një klimë të tillë.

4.

Klima shoqërore kundër së vërtetës mbi figurën dhe veprën e Dritëro Agollit u shfaq e plotë në ditët që vijuan ndarjen e tij nga jeta. Për këtë vepër u fol përgjithësisht përciptazi, madje fare përciptazi, në mënyrë deklamative, madje fare deklamative, pa rrokur thelbin e saj, pa rrokur thelbin e misionit të qytetarit dhe shkrimtarit Dritëro Agolli. Dhe, kur qëlloi të flitej me konkretësi, u nënvizuan përgjithësisht ato detaje, që e nxirrnin Dritëroin në dritë të shtrembër, në përputhje me bindjet, prirjet dhe shijet e sotme mbizotëruese, në përputhje me modën e së sotmes, me modën e egoizmit dhe të fitim-përfitimit.

Dritëro Agollin e panë sipas bindjeve dhe shijeve të tyre, e matën me kutin e tyre, e barazuan me veten, e kthyen dhe e bënë, si të thuash, shëmbëlltyrë të vetes së tyre (pse jo, edhe të veseve të tyre).

Ndaj tij u sollën siç sillen njerëzit e rëndomtë me diçka të bukur, e cila nuk u përket, mirëpo atyre u duket se duke e mbajtur pranë një bukuri dhe një vlerë të tillë, duke e veshur atë ashtu siç vishet një petk, bëhen edhe vetë më të bukur, më të hijshëm, më të vyer e më të pëlqyer në sy të të tjerëve.

Ishte një shfaqje publike tejet e rëndomtë dhe qesharake, në të vërtetë tejet e hidhur. Shoqëria jonë e zgjedhur dhe e përzgjedhur dëshmoi se ishte shumë larg kuptimit të rolit të figurave të tilla madhore si Dritëro Agolli, në të vërtetë dëshmoi se ishte tepër larg kuptimit të gjithë historisë së vendit dhe popullit tonë, larg kuptimit të thelbit tragjik të kësaj historie dhe sidomos tejet larg ndërgjegjësimit se në këtë fat tragjik të popullit shqiptar një rol të madh dhe të shëmtuar deri në turp kanë luajtur pikërisht paritë e Shqipërisë, të ashtuquajturat elita politike, ekonomike e kulturore të vendit.

Njëkohësisht shoqëria jonë e zgjedhur tregoi se ajo nuk e ka pasur asnjëherë ndjenjën e masës dhe sidomos të vetëpërmbajtjes në çaste të tilla të përzishme, sikurse është ndarja e dikujt nga jeta. Aq më tepër në rastin e ndarjes nga jeta të një figure me përmasa të mëdha, sikurse është Dritëro Agolli.


Dritëro Agolli

### E vërteta mbi të

E vërteta mbi figurën e Dritëro Agollit dhe rolin e tij në letërsinë, kulturën dhe historinë e Shqipërisë, nuk mund të dalë në pah pa vullnetin e nevojshëm, pa dëshirën e qartë për ta gjurmuar me ndershmëri, domethënë në mënyrë rreptësisht shkencore, këtë të vërtetë dhe për ta pasqyruar atë ashtu si shfaqet pas hulumtimit serioz, madje për ta shpalosur në mënyrë të hijshme, ashtu siç e meriton e vërteta.

5.

Për të rrokur të vërtetën rreth domethënies dhe vlerës historike të figurës dhe veprës së Dritëro Agollit nuk ka pikënisje më të mirë, domethënë më të drejtë, më të saktë, se të shtrohet thjesht dhe hapur pyetja: Kujt ia ka kushtuar veprimtarinë e tij të gjithanshme, kulturore dhe shoqërore, Dritëro Agolli? Që do të thotë: Kujt i përket figura dhe vepra e Dritëro Agollit? Vlerë dhe pasuri e kujt është në thelb trashëgimia e tij? Pra, kujt i takon ta mbrojë këtë trashëgimi?

Dritëro Agolli ka jetuar në tri

## Klima shoqërore kundër së vërtetës mbi figurën dhe veprën e Agollit

Klima shoqërore kundër së vërtetës mbi figurën dhe veprën e Dritëro Agollit u shfaq e plotë në ditët që vijuan ndarjen e tij nga jeta. Për këtë vepër u fol përgjithësisht përciptazi, madje fare përciptazi, në mënyrë deklamative, madje fare deklamative, pa rrokur thelbin e saj, pa rrokur thelbin e misionit të qytetarit dhe shkrimtarit Dritëro Agolli. Dhe, kur qëlloi të flitej me konkretësi, u nënvizuan përgjithësisht ato detaje, që e nxirrnin Dritëroin në dritë të shtrembër, në përputhje me bindjet, prirjet dhe shijet e sotme mbizotëruese, në përputhje me modën e së sotmes, me modën e egoizmit dhe të fitim-përfitimit.



Dritëro Agolli me bashkëshorten

kohë të ndryshme: miturinë e kaluar në kohën e Zogut dhe pjesërisht në periudhën e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare, e cila solli në jetën e tij përfundimin e fëmijërisë dhe kalimin e përshpejtuar në moshën e rinisë. Rininë, burrërinë dhe fillimin e pleqërisë (sipas kuptimit tradicional të kësaj fjale) i kaloi në epokën e demokracisë popullore. Pleqërinë e plotë dhe mbylljen e jetës i pati në kohën e demokracisë kapitaliste, “me idealet borgjeze faqe me nder demokratike” (F.Noli).

Vetë Dritëroi duke prekur çështjen e rolit përmbledhës, simbolizues, përfaqësues, të poezisë ka shkruar: “*Poezia e një poeti është biografia e tij*”. Kjo e përligj edhe më shumë drejtësinë e qëndrimit, i cili e merr trashëgiminë letrare si thelbin e veprimtarisë së shkrimtarit dhe niset prej kësaj trashëgimie për të arritur në përfundime të drejtpeshuara.

Në rastin konkret ne mund të fillojmë nga krijimet e kohës së fundit të jetës së Dritëroit për të bërë disa përgjithësime dhe vlerësime. Kjo është më e drejtë edhe nga një pikëpamje tjetër: për ne sot nuk ka gjë më të vlefshme sesa të qëmtojmë pësimet dhe mësimet e një figure qendrore të kulturës sonë pikërisht lidhur me kohën që po jetojmë. Dhe t’i lidhim këto pësime dhe mësime me jetën e tij në përgjithësi, me vetë kuptimin që kishte për jetën Dritëro Agolli.

Te poezia “Pelegrini”, e përfshirë në vëllimin poetik “Pelegrini i vonuar” që doli në vitin 1993, lexojmë:

Unë jam prej kohësh pelegrin,
Udhëtar në vendin e shpresës së thyer,
Jam ndarë pa dashur nga karvani im
Mes shtigjeve nga vapa dhe shirat gërryer.

Kërkoj karvanin tim në rërë e në shpat,
Karvanin që ka ndërruar drejtimin me kohë…

Disa gjëra tërheqin vëmendjen në këto vargje. Së pari, autori ka kohë që e ndien veten pelegrin, domethënë shtegtar, domethënë njeri kalimtar, në vendin e tij. Së dyti, kjo vetëndjerje e tij si shtegtar, si kalimtar, në atdhe (dashuria për të cilin ndeshet e qartë dhe e padiskutueshme në të gjitha veprat dhe krijimet e Dritëro Agollit, në të gjithë veprimtarinë e tij shoqërore), ka lidhje me faktin që atdheu është “vendi i shpresës së thyer”. Dhe, kur vendi amtar, kur populli janë shpresëthyer, është e vetëkuptueshme për poetin Dritëro Agolli që edhe ai vetë të ndihet shpresëthyer. Së treti, poeti përjeton ndarjen pa dashur nga karvani i tij shtigjeve të ashpra të jetës. Së katërti, ky karvan ka kohë që e ka ndërruar drejtimin e tij.

Duke lexuar këto vargje ne nuk mund të mos pyesim: Që një vend është shpresëthyer a do të thotë gjithashtu që ai është edhe shpresëhumbur? Dëshpërimi i këtyre vargjeve, madje edhe i shumë e shumë të tjerëve, tregon se për poetin në këtë rast thyerja e shpresës përputhet me humbjen e saj. Madje në shkallë absolute. Ja si shkruan ai në poezinë “Sikur s’jetoj më në vendin tim” (1996) përfshirë në vëllimin poetik “Fletorka e mesnatës” (1998):

Ky vend më duket do helmohet krejt
Nga helmi rrjedhur vrimash në themelet,
Pastaj do tundet toka në tërmet
Dhe Djalli i Madh do qeshë e do zgërdheshet.

I huaj jam në vendin tim mjerisht
Dhe kur rreth meje ka me dhjetra njerëz.
Kjo më lëndon dhe shpirtin ma gërvisht…

Nuk po ndalemi më tej në temën e rëndë të shpresës së thyer dhe të humbur. Thjesht po nënvizojmë edhe një herë pohimin e rëndësishëm: Poeti ndihet shpresëthyer dhe shpresëhumbur jo për diçka vetjake, jo për fatin e tij, por për fatin e një vendi të tërë. Sa ndryshon ky qëndrim nga egoizmi i një vargu njerëzish, të cilët janë qarë vazhdimisht për fatin e tyre, ndonëse kanë jetuar shumë më mirë se masa e gjerë e popullit shqiptar!

Kalojmë te një pyetje tjetër, që buron nga leximi i vargjeve të poezisë “Pelegrini”: Për cilin karvan e ka fjalën poeti, nga i cili ai është ndarë pa dashur? Për ku e ka ndërruar drejtimin karvani? Pse i dhemb kaq shumë poetit kjo ndarje? Kjo ndarje pa dashje a ka lidhje edhe me ndjenjën e vetmisë, të tëhuajsimit, që poeti shpreh në vargjet e poezisë “Sikur s’jetoj më në vendin tim” dhe që ai ndien edhe kur ndodhet mes “dhjetra njerëzish”?

Një gjë është e qartë, një gjë që sot përgjithësisht nuk kumbon në ndërgjegjen tonë shoqërore: vetmia shoqërore është shprehje e humbjes te ne të frymës së kolektivitetit, domethënë të frymës së të ndierit në shoqëri jo për shkak të ndenjjes fizikisht bashkë dhe mes të tjerëve, por sidomos për shkak të përbashkësisë së mendimeve dhe synimeve shoqërore.

Vlen të saktësohet këtu që kjo frymë kolektiviteti e ka burimin jo vetëm dhe jo thjesht te fryma e lidhjeve farefisnore e krahinore, por sidomos dhe mbi të gjitha te rritja dhe edukimi i njerëzve me ndjenjën e qytetarisë, me ndjenjën e përbashkësisë së fatit të qytetarëve. Sot kjo ndjenjë qytetarie, kjo ndjenjë përbashkësie e fatit, e jetës, nuk ekziston më. Ajo praktikisht nuk edukohet në asnjë institucion, në asnjë fushë të jetës. Kudo flitet për individin e suksesshëm. Vetëm për të. Dhe kjo praktikë e edukon qytetarin me pikëpamjen dhe bindjen që shoqëria nuk është veçse një grumbullim mekanik individësh, përgjithësisht të shkëputur e të përçarë dhe vetëm në rastin më të rrallë të lidhur në grupe e klane interesash të gjithfarshme – shumë shpesh joligjore dhe të jashtëligjshme – por asnjëherë të gjithmbarshme, mbarëshoqërore.

Dritëro Agollit i mungoi në periudhën e fundit të jetës, duke nisur të paktën nga viti 1992 (po të gjykojmë nga poezitë), pikërisht fryma e gjerë e kolektivitetit, e qytetarisë. I mungoi fryma, me të cilën ai u edukua gjatë viteve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe e cila iu bë e domosdoshme, jetike, si rrjedhojë e gjithë jetës së vendit në të ri e në burrëri, jetë të cilën ai e njohu si rrallëkush. I mungoi fryma, me të cilën ai u burrërua gjatë dhe falë gjithë veprimtarisë shoqërore e letrare që zhvilloi vetë. Ishte fryma e varganit të partizanëve, fryma e masave të punonjësve të qytetit e të fshatit, të përfshira në një punë madhështore për një Shqipëri të drejtë, pa shtypje e pa shfrytëzim.

Në periudhën e pleqërisë Dritëro Agolli njohu “lajkatarët, rrenacakët dhe smirëzinjtë, që shtireshin ëngjëj të dashur” dhe kuptoi se në këtë kohë “s’ka heronj, tani ka pehlivanë”. Ndaj edhe për cilësimin e botës zgjodhi fjalët “bushtër”, “zuskë”, “kënetë”, “botë e çmendur”. Ndaj edhe la amanetin e hidhur poetik (poezia “Sot pasdite”):

Mos ngjitni nekrologji me vija të zeza
Dhe mos ftoni farefisin dhe miqtë,
Askush mos mbajë fjalim në varreza,
Mos qajnë e mos lavdërojnë të ligjtë!…

Dëshpërim i thellë? Çështja është të shihet nëse ky ishte dëshpërim për veten. Dhe pamë që ishte një dëshpërim për halle shumë më të mëdha, për halle mbarëpopullore. Madje edhe në poezitë më vetjake në dukje të kësaj periudhe të gjitha përjetimet e autorit janë përgjithësuese në atë zymtinë e tyre, domethënë u flasin lexuesve të vëmendshëm dhe nuk i lënë të ftohtë ata. Ndërsa te “Poema e njeriut të zemëruar” sidomos mbresëlënëse është pika 16. E rëndë!

Është e qartë se një dëshpërim i tillë nuk është i këndshëm për klimën e sotme kulturore, kur njerëzve u ofrohet një model jetese me turizëm, prona dhe lloj-lloj kënaqësish (por pa punë), sipas parrullës “Jeta osh qef” (pikërisht kështu!). Dhe është e qartë se njerëzve të mbytur nga hallet zymtia e krijimtarisë së Dritëro Agollit në periudhën e fundit, pas vitit 1991, do t’u duket si kupë farmaku. Por, së paku e gjithsesi, nuk do të mund të thuhet kurrë që Dritëro Agolli i thuri himn kësaj “bote të çmendur”, për sa kohë që, sikurse shprehej vetë (poezia “Në të sotmen”):

Me sa duket nuk bëj për të sotmen.
Në të sotmen unë pakëz kam vend;
në çdo gjë e shoh lodhjen dhe ftohjen
dhe çdo gjë më mërzit e më çmend.



Dritëro Agolli

**vijon**

***Shpëtim Çuçka, përkthyes dhe publicist. Titulli kryesor është “Mesazhet e Dritëro Agollit”, (kujtimit të tij). Tiranë, majgusht 2017***

O
OPERA

*Opera "Jevgenij Onjegin" e Çajkovskit, është një opera e veçantë apo speciale, në të cilën dashuria është tema, karakteret dhe situatat sillen rreth aspekteve të dashurisë. Pra, dashuria është arsyeja që vëmendja përqendrohet në ata karaktere dhe çfarë ndodh me to. 'Onjegini' është shkruar nga një kompozitor i cili është futur thellë në kulturën Perëndimore të Europës.*

# "Jevgenij Onjegin", opera lirike në tre akte e P.I.Çajkovskit

NGA DR. SUL GRAGJEVI*

Është opera kryesore e Çajkovskit me libret të shkruar nga Konstantin Shillovskij, sipas romanit me të njëjtin titull të A.S.Pushkinit. Premiera e operës u bë më 29 Mars 1879 në Teatrin e Vogël, në Moskë.

Në letrën që i dërgonte S.I. Tanjejevit, Çajkovski i shkruante:*"Jam duke kërkuar një dramë intime, të fuqishme, e bazuar në konflikt"*. Kompozitori punoi shumë shpejt mbi operën e tij, në Moskë, në San Remo si dhe në Kamenka e Glebov. Për libretin e operës ndihmoi poeti K.S.Shillovskij. Më 11 Shkurt opera ishte përfunduar plotësisht dhe Çajkovskij njofton Nikollaj Rubinshteinin:*"Unë e përfundova operën në mënyrë të përsosur. Tani po merrem me libretin dhe kur çdo gjë të jetë në rregull dhe gati, do të nisem për në Moskë".* Qysh në fillim të punës, Çajkovski hasi në disa vështirësi që kishin të bëjë me subjektin e Pushkinit, para së gjithave, për mungesë konfliktesh tipikë si dhe për "*subjekte bashkëkohorë*" të pazakonshëm për operën.

Përveç kësaj, vdekja e një prej heronjve kryesorë ndodh në midisin e operës dhe jo në fund, opera në tërësi përfundon jo me ngjarje të efektshme dhe me skena masive por me dialog të dy personazheve. Kjo gjë nuk e ndaloi Çajkovskin që të përcaktonte kushtet më të rëndësishme në operën e tij, gjallëri, sinqeritet, poetikë të modelit të Pushkinit. Në përgjigje të kritikave, paraprakisht ai thoshte: "*Unë nuk gaboj, e di shumë mirë që efektet skenike dhe veprimet mund të jenë të pakta në atë opera, por poetika, humanizmi, thjeshtësia e subjektit me atë tekst gjenial, mbulojnë të gjitha të metat që mund të dalin". "Le të jetë opera ime e atillë. Por unë u dashurova me rolin e Tatjanës, unë u magjepsa nga vargjet e Pushkinit mbi të cilat shkruaj muzikën e cila më tërheq në mënyrë të pakapërcyeshme dhe për këtë unë jam i zhytur tërësisht në kompozimin e operas. Unë e shkrova Onjeginin sepse në teatër nuk është interesant sa në operën time*". "*Kjo opera, siç duket, së shpejti do të ketë sukses në të gjitha 'operat house' dhe ky sukses duhet të fillojë nga poshtë e jo nga lart*", thoshte Çajkovski.

Dhe menjëherë, opera arriti suksesin triumfal. Publiku u magjeps nga interpretimi i 'Romanit në vargje' të Pushkinit, i përkthyer në një muzikë madhështore.

Pas shfaqjes së Moskës më 1879, opera e Onjeginit fitoi statusin e operës lirike me të njohur. Shfaqja e parë e 29 Marsit u interpretua nga studentët e Konservatorit të Moskës nën dirigjimin e Nikollaj Rubinshtein ndërsa më 23 Janar 1881, operën e dirigjoi Eduard Napravnik.

Në St.Petersburg, opera u shfaq për herë të parë më 4 Maj 1883 nga solistët e Konservatorit në dirigjimin e K.Zike kurse në Pragë më 18 Dhjetor dirigjoi vetë autori i operës, Çajkovski. Opera shquhet për pjesë të bukura siç janë numrat muzikorë: ariozo e Olgës, e Lenskit, e Onjeginit, arietta e Tatjanës, aria e Lenskit, e Onjeginit, e Greminit.

Në rolin e Tatjanës kanë kënduar sopranot, Anna Netrebko, Renata Tebaldi, Renee Fleming, Mirella Freni. Në rolin e Onjeginit kanë kënduar baritonët, Dmitri Hvorostovskij, Jurij Mazurok, Ettore Bastianini, Mattia Battistini.Në rolin e Lenskit kanë kënduar tenorët Nikollaj Gedda, Giuseppe Di Stefano, Sergej Lemeshev, Nikollaj Figner. Në rolin e Greminit është shquar bassi ekspresiv i famshëm, Fjodor Shaljapin.

*"Ju mund të keni të drejtë të thoni se opera ime nuk do të jetë e efektshme në skenë*", i shkruante Çajkovski mikut, studentit të tij, Sergej Tanjejev, menjëherë pasi ai e kishte kompletuar aktin e parë të Onjeginit. Megjithatë, Çajkovski nuk e shihte si problem me rëndësi atë efektivitet si dhe anën dramatike duke thënë se nuk e shqetësonte aspak kjo gjë. *"Unë, për një ditë, me një forcë të papërshkrueshme arrita të shpreh në muzikë çdo gjë në Jevgenij Onjeginin".* Çajkovski që kur ishte 37 vjeç, kompozoi shumë punime për të cilat mbahet mend se janë, kuarteti i parë i harqeve, piano-koncerti në Si bemol minor, fantazi-uvertura Romeo dhe Xhulieta dhe baleti 'Liqeni i Mjelmave'. *"Unë thjeshtë shkrova muzikë për tekst të parashikuar",* ai më pas pranoi, *"pa menduar në të vërtet për ndryshimin e pafund midis stilit operistik dhe simfonik".* Në kompozimin e një opere, autori duhet të mbaj mend, thoshte Çajkovski, që teatri ka nevojë jo vetëm për melodinë dhe harmoninë, por gjithashtu edhe për veprimet në skenë. Gjithashtu ai thoshte që *"nuk jam me një opera në të cilën subjekti të jetë me mbretër, mbretëresha, me beteja, marshe, për t'iu referuar termit "grand opera", unë jam duke parë për një dramë intime, të fuqishme, e cila është e bazuar në një konflikt të rrethanave mbi përvojën time ose dëshminë që mund të më prek thellësisht në ndjenja".*



"Karmen" i Bizesë është një nga operat më të përsosura në ditët tona, shprehej Çajkovski i cili ishte për një vizitë në Paris më 1876, (disa muaj para se të nisej për në Bayreuth) për të parë "Karmenin" e Bizesë nga e cila u shokua. Vëllai Modesti që ishte me të në shfaqje tha: *"kurrë nuk e kam parë kaq të eksituar Peter Iliçin*". Bizet është një artist, thoshte ai, i cili i kushtoi nderim modernizmit, "*ja çfarë subjekti i mrekullueshëm për një opera si Karmeni, unë nuk mund ta luaj skenën finale pa lot në sy".* Një subjekt i tillë i operës ofron një lloj ndershmërie dramatike të cilën Çajkovski mundi ta gjente. Në një takim me këngëtaren Elisaveta Lavrovskaja, më 30 Maj 1877, e cila e këshilloi Çajkovskin të shkruante operan mbi subjektin e Jevgenij Onjeginit të Pushkinit. Në fillim ky mendim iu duk i vrazhdë porse, kaq shpejt e kapi në dorë sa që brenda një nate, ai shkroi skenarin dhe përshtati muzikën. Çajkovski e admironte Pushkinin. Elementët tregimtarë të masterpjesës të Pushkinit janë paraqitur qartë dhe me koherencë dramatike duke përmbushur kështu qëllimin e kompozitorit. Pjesa humane e saj do të sigurojë interes dhe një poezi të plotë, dhe Çajkovski, ishte i bindur në tekstin e Pushkinit që do ta frymëzonte në zgjedhjen e linjës muzikore. Kjo është dituri e jetës, e karakterit të njeriut Rus, kuptim i hollë i natyrës Ruse, muzikaliteti i vargjeve të Pushkinit, e, të gjitha këto, sollën te kompozitori kënaqësi, admirim. Nga romani në vargje, i Pushkinit, të cilin V.G.Belinskij e quajti :"Enciklopedi e jetës Ruse"- Çajkovski mori vetëm atë që ishte e lidhur me qetësinë shpirtërore dhe fatet personale të herojve të Pushkinit duke e quajtur operën e tij thjeshtë, "skenat lirike". Që në fillim, karakteri i Tatjanës, më mirë nga Onjegini, shtoi dashurinë dhe dhembshurinë e Çajkovskit. Një kohë, Çajkovski e konsideronte të rëndësishme letrën e famshme në të cilën Tatjana i shpreh dashurinë Onjeginit. Dhe kjo si një pjesë vokale e veçantë, përbënte një skenë të mrekullueshme në të cilën kompozitori i kthehet kujtimeve të ditëve të Moskës. Tatjana nuk është vetëm një zonjë e re nga provinca, që bie në dashuri, por ajo gjithashtu është e bukur, thotë Çajkovski, me një natyrë ëndërruese, e padjallëzuar në shpirt, e sinqertë karshi realitetit të jetës. Çajkovski i shkruante vëllait të tij Modest: *"Le të ketë opera ime mungesë efekti skenik, le të ketë veprim apo aksion të pakët, se, unë jam i dashuruar me imazhin e Tatjanës, unë jam i magjepsur nga poezia dhe vargjet e Pushkinit dhe për këtë, jam i detyruar të shkruaj muzikën më të bukur".* Muzikën për Skenën e Letrës, Çajkovski e përfundoi tetë ditë mbasi kish arritur në vendin e tij. Kjo ishte thelbi i rezultatit të Çajkovskit nga i cili, opera shkoi më tej jo vetëm në materialin tematik por edhe në ngrohtësinë muzikore dhe para së gjithash, një skenë e jashtëzakonshme që pasqyron portretin e Tatjanës. Çajkovski ishte shumë i zënë me mendimet rreth Eugene Onjegin si opera, por në mënyrë të veçantë, për karakterin e Tatjanës, letra e së cilës e tërhoqi në këtë kompozim. Kaq shumë ai ishte i eksituar nga 'Skena e Letrës' që kish në dorë, sa që kishte harruar edhe letrën e dytë që ia kish dërguar Miljukova, e të cilën, e gjeti pas disa ditësh. Pse ndodhi kështu?- Sepse Çajkovski ishte familjarizuar me figurën e Tatjanës e cila ishte bërë për të, personi më i afërt. Çajkovski do të shkruante një tjetër muzikë për Onjeginin, nuk pëlqente lirizmin për të, duke iu referuar tonit jo emocional. Ai do ta shkruante muzikën e tij me kënaqësinë më të madhe dhe ishte shumë i sigurt që subjekti poetik dhe teksti i papërshkrueshëm, i bukur, do të jetë me shumë efekt.

Me Valcin dhe Mazurkën në skenën e parë të aktit të dytë, Çajkovski e pasuroi mjaft muzikën e operas, ashtu si në skenën me 'Polonezen' e bukur në fillimin e aktit të tretë. Megjithatë, Çajkovski nuk harroi të trajtonte nivelin e tij dramatik, krahasuar më shtjellimin e ballos së St.Petersburgut në fillimin e aktit të tretë për festimin e ditës së emrit të Tatjanës së re. Në operan e tij, siç pohonte vetë Çajkovski, është i pranishëm elementi Rus, këngët Ruse, të zhvilluara në raport me melodité e tij dhe harmonitë, sepse, thoshte ai, "u rrita në provincat që më frymëzuan qysh herët, në fëmijëri, me veçoritë e papërshkrueshme të bukurisë së folk-muzikës Ruse dhe sepse, unë me pasionin më të madh e dua elementin e tyre Rus në sensin e plotë të termit". Siç është e ditur, Çajkovski nuk ishte nacionalist dhe nuk kishte simpati për grupin nacionalist "të pestët" të cilët e kritikonin për 'gjermanizëm'. Vetëm në pjesën e dytë korale të fillimit të aktit të parë të 'Onjeginit' mund të vihen re pjesë të

## Shembulli i "Onjeginit"

'Onjegin' është një shembull ndriçues i Operas Lirike Ruse. Ashtu si në baletet e famshëm, Çajkovski në muzikën e kësaj opere solli shumë elementë simfonikë, solli një orkestracion të përsosur 'kadife', solli arie të bukura, të këndshme, melodioze, solli muzikën më të bukur të dansit nga të gjitha operat e tjera, valcin, polonezen.
'Onjegin' është e vetmja opera Ruse me një universalitet që e bëri atë shumë popullore.

## Kur u shfaq për herë të parë

Në St. Petersburg, opera u shfaq për herë të parë më 4 Maj 1883 nga solistët e Konservatorit në dirigjimin e K. Zike kurse në Pragë më 18 Dhjetor dirigjoi vetë autori i operës, Çajkovski.
Opera shquhet për pjesë të bukura siç janë numrat muzikorë: ariozo e Olgës, e Lenskit, e Onjeginit, arietta e Tatjanës, aria e Lenskit, e Onjeginit, e Greminit.

F
FORUM

*Shkrimtari i njohur malazez Vladimir Vujonoviç ndau emocionet dhe përshtypjet e tij në një mbrëmje letrare në Tiranë, organizuar nga POETEKA, pak ditë më parë. I shoqëruar nga shkrimtari i njohur malazez me origjinë shqiptare Jovan Nikolaidis, ai iu përgjigj shumë pyetjeve për bashkëkohësinë e letërsisë së sotme malazeze, gjuhën e vendit të tij në letërsi dhe debatet e ndryshme në vend, që lidhen me të...*

# Shkrimtari Vladimir Vojinoviç në Tiranë: Ballkani ka problem të njëjtë tranzicionin

NGA BEN ANDONI

*Problemi më i madh dhe i përbashkët, që haset si shqetësim në të gjitha letërsitë e vendeve ballkanike ka lidhje me tranzicionin, mënyrën sesi është përcjellë në vende të ndryshme dhe sesi ato e kanë përjetuar. Shkrimtarët pothuaj hasen me të njëjtat realitete dhe përgjigjen ndaj tyre"*, thotë shkrimtari Vojinoviç. Ai i ndau pyetjet për krijimtarinë e tij, emocionet dhe përshtypjet letrare në një mbrëmje artistike në Tiranë, organizuar nga POETEKA, pak ditë më parë. I shoqëruar nga shkrimtari i njohur malazez me origjinë shqiptare Jovan Nikolaidis, ai iu përgjigj shumë pyetjeve për bashkëkohësinë e letërsisë së sotme malazeze, gjuhën e vendit të tij në letërsi dhe debatet e ndryshme në vendin e tij, që lidhen me të, por nga ana tjetër ai bëri të njohur shumë nga problematikat vendase, që zenë vend në krijimtarinë e tij. Deri më sot në shqip, ka ardhur një përmbledhje tregimesh prej tij, titulluar "Tregime nga Montanari", përkthyer nga Dimitrov Popoviç. *"Si ke mbyllur faqen e fundit të vëllimit, jo veç lexuesi ideal, por edhe ai real, e ka lehtësisht të verifikueshëm se personazh kryesor është mbase vetë autori, pra një shkrimtar a intelektual e kjo ka e s'ka gjithaq rëndësi. Në dymbëdhjetë tregimet që autori na paraqet, përmes narratorit, sidomos përmes dialogësh e monologësh, na përcjell mesazhe, hera-herës edhe të mbuluara nga një tis filozofik impresionues.*

*Realiteti e simbolika që e rrethon këtë prozë, shpesh edhe si brerore pa e kaluar masën, të imponojnë që të mos lexosh shpejt, edhe pse i njëjti apo i përafërti personazh shtegton sa në njërin në tjetrin tregim, pasi individualizimi që u ka bërë na flet për pjekuri artistike të autorit"*, ka folur për tregimet e tij Skënder Temali, Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shkodër-Shqipëri.


Vladimir Vojinoviç

## Vladimir Vojinoviç

Vladimir Vojinoviç ka lindur në vitin 1978 në Nikshiq. Ai u diplomua në Gjimnazin "Sllobodan Škeroviæ" në Podgoricë. Ai u diplomua në vitin 2003 në Fakultetin Filozofik në Nikshiq, Departamenti i gjuhës dhe letërsisë serbe me temën "Letërsia Sociale dhe Nikolla Lopiçiç". Nga viti 2004 deri në vitin 2011 ai ka punuar si gazetar në gazetën e përditshme të pavarur "Vijesti". Ka diplomë master në vitin 2008 në Fakultetin Filozofik në Nikshiq, ku mbrojti tezën e titulluar "Historia midis dy luftërave Milovan Gjilas. Ai ka marrë PhD e tij në vitin 2014 në Fakultetin Filozofik në Nikshiq, me tezën e doktoraturës "Status gojor në historinë e shkruar në Mal të Zi nga viti 1990 deri më 2006". Në vitin 2014 ai punoi si redaktor kryesor në Institutin për tekstet dhe ndihmën e mësimit në Podgorica. Është autor i tri monografive shkencore. Është autor i disa pjesëve letrare dhe aktualisht mban edhe detyrën e Presidentit të Shoqatës së botuesve të Malit të Zi nga Podgorica dhe drejtor artistik i çmimit "romanit më të mirë të pabotuar të Malit të Zi".

Në mbrëmjen e Tiranës që është përcjellë me shumë interes nga përfaqësues të ndryshëm nga auditori letrar është folur përveçse për krijimtarinë dhe shumë pika takimi, që përball letërsia e sotme ballkanike, si edhe letërsia që bën vetë autori. Për autorin është shumë interesant jo vetëm thjesht por edhe problemet e sotme, që kanë natyrë politiko-sociale. Vojinoviç ka qenë shumë interesant edhe sa i përket sqarimit teknik të veprës së vet. Ai është treguar i hapur dhe tejet bashkëpunues për të gjitha pyetjet e bëra, veçse ka dhënë edhe konsideratat e veta.

Në këtë mbrëmje është folur edhe për romanin "Ne budi je", një vepër që autorin e ka shfaqur shumë të formuar edhe si prozator, në gjininë e vështirë masive të rrëfimit.

"Një histori e cila nis nga një rrëfim që e tregon shumë të përgatitur. Duket pak si histori autobiografike dhe ndërthuret me historinë e një brezi të tërë. Autori jo thjesht na shfaqet serioz por tregohet i saktë në një proces, ku brenda ndërfuten histori të rënda, siç janë ato që lidhen me pasojat e luftës.

Vetë historia e personazhit kryesor ndërthuret me Çako, Van Dam, Goran, Caca, Bolje Junior i Bolje Senior, Nina dhe të mban të ngërthyer deri në fund. Një histori e një brezi që paslufte vuan traumat psikologjike dhe realitetin e një jete të vështirë.

Mjeshtëria e autorit është se pas asaj që rrjedh në rrëfimin e tij, ke ndjesinë se kap ndjesinë e një krijimi tjetër. Njëra është ajo që lexon autorin me kujdes të cituar dhe tjetra fati i keq dhe i trishtueshëm i një brezi.

*Megjithëse personazhet nuk mbahen shumë dhe vetë libri ka një vëllim të vogël, ne përballemi me një galeri të tërë të karaktereve të cilat është e vështirë të harrohet*", është thënë nga njohës të veprës së tij.

Mbrëmja ka ndarë përshtypjet letrare dhe me një sërë autorësh të tjerë shqiptarë, që ishin të pranishëm në këtë event.

---

folk-muzikës Ruse, dhe jo vetëm kaq, por asgjë nga muzika e Balakirevit apo e Mussorgskit nuk gjendet në notat e Çajkovskit. Ndikimi i muzikës Perëndimore te Çajkovski është pothuaj po aq sa ai Rus. Kështu, hijet e "Karmenit" të Bizesë duken edhe në operën "Eugene Onegin" të Çajkovskit, siç është kënga e luleve e Don Jozes, prapa së cilës qëndron melodia e Skenës së Letrës, në të njëjtin Re bemol maxhor. Çajkovski e adhuronte muzikën e "Karmenit" dhe do të ishte i lumtur, thoshte ai, sikur të arrinte një rezultat të tillë. Përfundimi i aktit të parë u prit me shumë kënaqësi nga kolegët e tij duke filluar që nga Rubinshteini. Skenën e duelit, Çajkovski shkoi ta shkruante në malësi që ta përfundonte. Mori me vete letra, lapsa për të punuar. Më 13 Shkurt 1878, Çajkovski shkruante: *"Sot përfundova të gjithë operan Jevgenij Onjegin dhe për këtë jam në gjendje shpirtërore shumë të mirë ......"*. Kur ai e luajti të gjithë operën në pianon e tij, duke qenë vetë dëgjues i saj, tha: *"Më vjen zor t'ju them juve një sekret; dëgjuesi doli përjashta me sy të përlotur"*.

Interlud

Opera "Jevgenij Onjegin" e Çajkovskit, është një opera e veçantë apo speciale, në të cilën dashuria është tema, karakteret dhe situatat sillen rreth aspekteve të dashurisë. Pra, dashuria është arsyeja që vëmendja përqendrohet në ata karaktere dhe çfarë ndodh me to. 'Onjegini' është shkruar nga një kompozitor i cili është futur thellë në kulturën Perëndimore të Evropës.

'Onjegini' nuk ishte një opera në sensin tradicional, por një seri që kompozitori e quajti 'skena lirike në tre akte'. Secila 'skenë lirike'e progresit dramatik është e pasur në shije dhe aromë. Për këtë tragjedi romantike të një dashurie të dëshpëruar, Çajkovski, ashtu si në pjesën më të madhe të punimeve të tij muzikore, shkroi muzikë plot emocione. Nuk mund të mos përmend skenën e bukur në shtëpinë e Larinës ku janë mbledhur për ditën e emrit të Tatjanës. Gradualisht, muzika ndryshon duke kaluar në muzikën e dansit dhe të ballos, në valc, që ndoshta është më e bukura e të gjithave. Çajkovski njihet si kompozitori më i madh i dansit, çka duket jo vetëm në tre baletet e famshëm por edhe në 'Onjeginin'. Për këtë arsye, muzika e tij pëlqehet nga të gjithë. Në skenën e gjashtë, polonezja e Çajkovskit ngjallë ndjenja të tjera në krahasim me muzikën tjetër të dansit në opera. Kjo ishte një mënyrë tjetër efektive që Çajkovski i jep kolor emocional dhe rëndësi skenave në operan "Jevgenij Onjegin". Në performancën e Met Operas NY, që dirigjoi James Levine, Mirella Freni ishte e vetmja Italiane e cila arriti suksesin e rolit të saj nga që e martuar me bassin Nikollaj Ghiaurov, që e njihte shumë mirë repertorin Rus, ajo realizoi interpretimin në mënyrë të përsosur jo vetëm të Tatjanës por edhe të Lizës te 'Dama Pik' e Çajkovskit. Performanca e vitit 2007 në Met Opera është dirigjuar nga Valerij Gergijev me Dmitri Hvorostovskij (Onjegini) dhe me sopranon Amerikane Renee`Fleming (Tatjana) dhe ishte e jashtëzakonshme, brilante, në të cilën të dy këngëtarët kryesorë kënduan dhe vepruan në mënyrë magnetike ndersa Gergijev dirigjoi, plot pasion e temperament, në mënyrën e tij 'çajkovskiane' duke i dhënë mbështetje lirike dhe dramatike këngëtarëve (versioni dvd). Skena e famshme e Letrës ishte e paharrueshme dhe dialogu/duet në hapjen e aktit të parë, midis dy mezzosopranove ishte shumë prekës. Tenori i njohur Ramos Vargas (Lenskij), ishte një Lensk Shubertian, këndoi plot zell.

'Onjegin' është një shembull ndriçues i Operas Lirike Ruse. Ashtu si në baletet e famshëm, Çajkovski në muzikën e kësaj opere solli shumë elementë simfonikë, solli një orkestracion të përsosur 'kadife', solli arie të bukura, të këndshme, melodioze, solli muzikën më të bukur të dansit nga të gjitha operat e tjera, valcin, polonezen. 'Onjegin' është e vetmja opera Ruse me një universalitet që e bëri atë shumë popullore. Në këtë opera ka rëndësi vendosja e tre apo katër këngëtarëve më të mirë, të cilët duhet të jenë të klasit por edhe aktorë të mirë të skenës njëkohësisht.

Siç dihet, opera e 'Onjeginit'përbëhet nga 3 akte dhe 7 skena me 22 numra por pavarësisht këtyre ndarjeve të bëra nga Çajkovski, ai përdori leitmotivin dhe kjo nuk do të thoshte që opera ka diçka nga Wagner, asgjë nuk është 'ëagneriane', por përkundrazi çdo gjë në atë opera është vetëm 'çajkovskiane', e freskët dhe cilësore si në vitin 1878, për 3 orë e 10 minuta, në të cilën xhelozia solli tragjedinë, duelin përfundimtar. Thelbi emocional i operës është Tatjana, një vajzë e re, e pafajshme, që bie në dashuri me Onjeginin dhe që ëndërron një pranverë të shndritshme. Aria e saj emocionuese e aktit të parë është skena e Letrës: "*Më lë mua të vdes por më parë .....*" Princi Gremin, bass, edhe pse shfaqet shkurt në aktin e tretë, ai ka një nga ariet më të bukura në të gjithë operan, i martuar dhe i dëshpëruar, pa asnjë shpresë në dashurinë e Tatjanës.

Pa marrë parasysh disa kritika në gjykimin e operës, 'Eugene Onegin' u prit me shumë ngrohtësi nga publiku dhe brenda një kohe të shkurtër u bë e vetmja opera popullore në Rusi duke u shfaqur 16 herë brenda dhe jashtë, gjatë kohës së Çajkovskit (J.Kelldysh). Me sukses të madh opera u shfaq në skenat e Teatrit "Balshoj" (1881), kur në vitin 1963 u bë spektakli i 1500 i saj, si dhe në teatrin Marijnskij të St.Petersburgut (1884) ajo u bë produksioni më popullor.

***Dr. Sul Gragjevi, kritik muzike***

# P
## POEZIA

*Ky është një cikël që është afruar nga autori për "Milosaon". Përmbledhja e fundit, e kuruar prej tij, është edhe një lloj reagimi për kohën ku jetojmë, por edhe gjendjen e vetë autorit.*



NGA MOIKOM ZEQO

## I VETMI APOSTULL

I besoj veç një kalendari të poetëve, ku çdo gjë në kohë, s'korrigjohet dot më, në Përjetësi!
Ç'është kjo femër, që e mban universin nën sqetull, si kutinë bosh të violinës?
Një lehje e qenit molos në buzëmbrëmje është përkthim i heshtjes së yllit më të largët!
U drunjëzuan ngjyrat onufriane të vjeshtës në miliona ikona!
Dhe unë jam i Vetmi Apostull!
2013

## TREGIMTARI MEMEC

Një vizatim fëmije, e rikonstrukton sërish
Qytetin e të Humburve, në mijëvjeçarët barbarë!

Me zambakët dhe lulekuqet e shpik
Një simultante shahu të paparë!

Mbase kjo dhi e shkathët në cërka
I spjegon tërë ëndërrat e mia!

Dhe Don Kishoti e mat amëshimin e paradokseve
Me orën me katër akrepa të mullinjve!

Dita mbyllet mbi mua, si kapaku
I kutisë së violinës, mbas koncertit të madh !
***
O, zogj, që shkëputeni nga kthetrat e druve,
Rrufetë më magnetizojnë idetë, deri në Zenit!

Ah, për milingonat,
Pluhuri është kontinent me male!

Dhe unë ende paguaj me ditët,
Që nga valuta e vetme e fëminisë!

I mbyllur jam
Në geton e librave!

Natyra e ka një regjizor të padukshëm
Dhe unë jam për të i vetmi publik!

Lumi i Letës ujit drithëra të dobët,
Bimë helmi, me fanitje fosforente!

Mos i kapni fluturat,
Që i krijojnë ëndrrat e poetëve !

A mund të shpiket një zgjua i ri,
Për xixëllonjat bletë ?
***
Gjumi im vërtitet në qiej
Me pelikanë të vdekur !

Ç'magjistar shkon në të Ardhmen,
Për të gjetur të kaluarën ?

Dhe drurët në lumë
Janë si qimet në pubis!

Dhe qielli është tejkalim i qartë
I sendeve të errta!

Dhe bota e të vdekurve
Është kinematografi gnostike!

Shekuj! Ua kërkoj vëmendjen,
Unë, tagrambledhësi i metaforës!

Ah, dëgjoni, dëgjoni,
Si klithin të rebeluarit në Parajsë!

Nga syri im del loti
I demit të shenjtë Apis!

Do ta rrjep, do të shkul
Nga shpina e Vjeshtës lëkurën e ylberit!

Ç'janë këto shtëpi,
Me mure, ndërtuar me klithma?
***
Pse peshqit, do të na i rrëmbejnë fjalët,
E gjuhës, që e lamë të vdiste?

Ah, as udha e njohur e shtëpisë së lindjes,
Asgjëkundi tani nuk na çon!

Dhe s'di pse shoh frutat e stinës
Si bebëza engjejsh!

Pse kjo lule,
Ëndërron të bëhet shkronjë ?

Dhjetë ujëvara
Janë duart e mia !

Dhe mesdita e artë
Është mbyllur në shishen e detit!

Por nositi ende s'mëson
Të vdesë si njeri!

***
Largësia midis pyetjes dhe përgjigjes
Është një det pa emër!

Guri i unazës
Krijon një Hollivud ëndrrash!

Po kush syrin e dragoit
E bën gur unaze?

Prekja e anijes me detin
Është një lloj seksi!

Po gjumi i prishur
Është bukë myku plot lavra!

Ca pëllumba surrealë
Çajnë stinët me gjoksin e anijeve homerike!

I kam mësuar përmendësh tërë këto peizazhe
Si numratore telefonash të miqve të dashur!

Kur të vijë Nata ime e Mbrame
Ndizni detin në flakë!

Pse Zoti, Zoti,
Na urdhëron të mos i ngjajmë vetvetes?

Ja, një kafkë fëmije, që mund të bëhej burrë,
Ja, një çast i vetëm, që mund të bëhej shekull!
***
Ah, unë jam si qielli,
S'e ç'vendos dot vetveten!

Ç'ide të një Libri Misteresh,
M'i sjellin këto dallgë?

Ah, këta drurë,
Janë shqisat e stinës së shkrumbosur!

Gjithë detet e tharë



Mund t'i kthej në kopshte trandafilash.

Dhe Vjeshta e artë
Është ikonë kishtare!

Onufri, e shikon,
Dhe mbushet me lotë!

Si vjen kështu Monterverdi,
Me muzikë dhe tek thonjtë e duarve?

Ndërsa Mozarti thua se arnon
Një kostum argjenti,

Për vdekjen e tij
Të paidentifikuar !
***
Dhe unë jam Spartaku, skllav i fjalës,
Për t'ju dhënë juve lirinë e shpirtit!

Asnjë grindje ererash
S'është dialog!

Do të zgjas këtë ditë, që po shuhet,
Veç me dritën e syve!

Por edhe shegët e çara
Ushqejnë agimet e vijuara!

Statujat s'e dinë
Ç'do të thotë tepri e moshës!

Virgjëresha,
Pret në errësirë prekjen e Hyut!

Befas ca xixëllonja të mëdha
Shpërndahen si tufa lejlekësh!
***
Do të vijë një ditë si slogan i brohoritur,
Po pranvera i ka djegur tërë adresat e saj!

Shkretëtirat
Kanë dete në zemër!

Trupi vigan i Milosaos, atje larg,
Befas ngrihet si grigjë shqiponjash!

Edhe në eshtra s'do të më braktisë
Enigma e Njeriut!
***
Dhe mbase këtij liqeni
S'do t'ia shohim dot fundin,

Si na ndalohet t'i hapim
Arkivolet e vampirëve poetë!
***
Si mund të shpike hieroglife,
Nga lëvizjet e ngjalës detare,

Një shkrues i vjetër
I Egjiptit?

Poeti gjendet i mbytur përherë
Në një baticë yjesh!

Veç një këndez i zi, i vetë Vdekjes,
Mund të më zgjojë prej saj!

Shpesh, jam i pashprehshëm,
Si alfabeti, ku mungojnë zanoret!

Dhe fjalët pakësohen
Si fauna, që zhduket!

Çdo Tregimtar Memec
I di germat e zeza, që tymi i shpik!
Durrës, 25 maj 2013

## GRIFONI MBAS SHPATULLAVE

Mbas shpatullave të mia merr frymë një grifon!
Mbase unë e gjej në qiell një kontient të panjohur, plot popuj dhe qytete me përmendore dhe shkrime misterioze!
Veç Naim Frashëri e donte një lulëzim, që do të zgjaste sa

njëqind pranvera!
Mbase të vdekurit pijnë duhan!
Ndaj del ky avull i çuditshëm nga varret!
*2013*

## VDEKJA MË KA BRAKTISUR

Dikush, me fijet e vetëtimave end në tezgjahun e shtrëngatës qilimin përrallor.
Si çeli kështu kjo gonxhe trandafili në kopështin tim si një Jezu fëmijë?
Ca qytete të banuaran nga yjet s'i pranojnë si refugjatë as njerëzit, as zogjtë!
Ah, dua të vdes! Dua të vdes! Por vetë Vdekja më ka braktisur!
2013

## ZODIAKU, LETRAT E BIXHOZIT

Tani afreskoj me agimet e mrekullueshëm të Durrësit qiejtë e tërë planetin!
Mijëvjeçarët m'i trazojnë flokët e mi!
Dhe Heshtja është vendlindja e humbur e fjalëve!
Dhe heronjtë janë farat tona, tashmë të shuara! Ah!
Zodiaku, letrat e mia të një bixhozi kozmik!
Pse luaj?
Për të fituar të Paarritshmen, që është Hiçi?
2013



## AGIMI HUNGËRIN MBI DELFINËT

Ah, qytetërimet i kanë tradhtuar
Heronjtë e dikurshëm!
Po pse akoma me supet e Shën Marisë
Rri kukuvajka e diturakes Minervë?

Pse o, Njeri, edhe nëse s'di,
S'do të mësosh si qenien tënde ta mbjellësh?
Vjeshta ëndërron krejt e lirë,
Brenda gjumit të Hirushes!

Fosforeshente, e brishtë është Kisha e Prillit
Për Meshat e mia Sekrete!
Agimi tani është prej race shtazore
Dhe hungërin mbi delfinët!
*2013*

## VAJTON KOMBI I MARIVE

Më bije në fytyrë shiu i jaseminëve!
O, klientë të mrekullive!
Pse tuberkulozin e Migjenit e mbart edhe lumbardha e De Radës?
Sa libra virtualë për këtë realitet të vrazhdë!
Veç ka edhe peizazhe, të praruar nga brenda, si bazilikat e mëdha!
Si vajton kështu tërë kombi i Marive mbi plagët e mia, shpërngulur që nga Golgotaja?
2013

## Ç'VETËTIMË ËSHTË MBARSUR ME MUA?

Ja, në mes të ditës u shfaqën
Tri Hëna dhe padyshim një kometë jeshile!

Këngët janë thinjur
Nga rruga!

Fati im mizor i shndërron
Tërë dragojtë në tatuazhe!

Dhe tigrat me gji dhie
U japin qumësht foshnjeve të klonuara!

Ndërsa Matematika rrit
Qerpikët e saj si numra romakë?

Në kundërshtim me rutinën
Ndoshta vijnë edhe netë të portokallta!

A është drita një Pegas,
Që mund të më mbartë?
***
Ç'është kjo lëvizje milingonash,
Si gërvishtje e penës, që pikon bojë në letër?

Shoh kudo zjarre kacavjerrës
Me kthetra!

Mali refuzon
Të shkojë tek Profeti!

Dhe metrotë në metropolet e botës
Ngjajnë me katakombet e krishterëve të hershëm!

Deti zbrazet,
Por mbushet Vetmia!

Ku ikën, ku shkon ky tren i gjatë,
Metalizim i lëkurës së gjarprit totem?

Ah, tek Mali i Lejlekut
S'ka më lejlekë!

Dhe qesh ulkonja
Me dhëmbë të florinjtë!

Dhe unë pi kafe te një kullë rrotulluese
Me trupin e vjetër prej Neandertali!

Ah, këto re, këto re,
Amfora të mbushura me korent zeusian!

Ikin me vërtik, në oqeanet
Tritonët piratë!

O, Zot! Nga hiri i urnës së Neronit
Bëj një Krisht të Ri!

Do të mbretërojë merimanga
Në pezhishkën e nervave tona!

Steve Jobs! Si ta përkthej
Mistikën në një kod interneti?

Vdeksha unë përherë,
Që ju, që ju, të jetoni !

Fluturimi im, s'është
Vetëm i një zogu, por i tërë zogjve njëherësh !

Ç'lopë e çmendur,
Me papijon jargësh në gjoks !
***
Ah, lehja e qenit në vendlindje
Bëhet befas meteor !

Shpirtrat ulërijnë ! Kryepiratja Vdekje
U grabit vetëm trupat !

Si ta bëjmë një piknik,
Gjer tek gjuhët e vdekura ?
***
Si më del kështu përpara
Ky det sferik?

Në xhepin e fëminisë e kam peshkune artë
Edhe kur jam në bjeshkët e epërme!

Dhe fjalët janë
Plot trille nimfatike!

Dhe dhelprat rrinë si vetulla
Mbi shkëmbinj!
***
Në mungesë të luleve,
Pranvera të krijoi ty e dashur!

Dhe unë shkruaj,
I mbyllur tek një bubullimë!

Pse është në pikëllim Virtyti
Dhe Vesi në triumf?

Në ç'gosti përrallore jam në ëndërr
Dhe kaq i uritur në zgjim?
***
Vjeshta ëndërron për gjethe të reja,
Si të vdekurit për t'ju kthyer zërat përsëri!

Vetëtimat shtatzëna
Pjellin luanë elektrikë

Po cila, nga këto vetëtima,
Është e mbarsur me mua?
*2013*

## FJALËT E SHTRIGËRUARA

Te drita e xixëllonjave rreh pulsi i trupit tim !
Zarathustër, pagëzomë me zjarre !
Tokë, pagëzomë me det !
Det, pagëzomë me Hënë !
O, si na u sulën dhe na hëngrën imazhet, ne, të gjallëve !
Si ikën ky zog, si një sy, i përzënë, nga një ballë mendimtari ?
Sa të shtrigeruara janë fjalët !
013

## TË VDEKURIT ME VETULLA SHKËMBI

Në një botë absurdi të gjithë vriten, por askush nuk vdes !

Lexoj trishtuar vargjet :
De la mer nait le sel
De la famme le mel !*)
Jashtë dritares bjen shiu i mesnatës.
Si ta lag me të peiazhet e ëndërrës, që po shoh?
Të vdekurit kanë vetulla shkëmbi, ku mbijnë portokaj dhe kaktusë mitesh !
2013

__________
** Deti lind kripën*
*Femra të keqen ! frëngjisht)*

## KAKTUESI, AVOKATI I ABSTRAKTES

O, kalorës qiellorë, të ngrirë, të varur nga sipër, si stalakmite, si në pikturat e Salvator Dali-së !
Po pse unë ndihem pa emër, mes Askushit dhe Gjithkushit, mes Çdokushit dhe Misterkushit !
Vjeshta, më kot, rrëmben maska të Ekuinoksit !
Uji vetëtin, mes enës prej bronxi në zjarr !
Si ta heq këmishën time të detit ? Dhe kështu t'ju përqafoj !
Ky kaktues është Avokati më i madh i Abstraktes !
2013

## POETI, KUSHERI ME VDEKJEN

Nëse trandafilat do të bëjnë seks
Me gjarpërinjtë,
Do të të rishpiken dragojtë,
E pupurt, fluturues!

Ku arratiset kështu xhindi im, i metaforës?
Si ta përshkruaj gjithçkanë,
Por pa fjalë?

Ç'kujë e erës ka mbetur në fytin e luleve?
Moshën e kalit,
Si ta shoh nga dhëmbët e Hënës?

Ah, qielli është Virgjëresha,
Me sisët e bardha të reve!
Poeti është kushuri me vdekjen,
Me prekjen e duarve ringjall çdo gjë!
2013

## TELEFON PËR ËNDËRAT

Te vrima e djegur nga cingarja në këmishë, më hyn dhe më del, përralla e Hamletit!
Mjekrrat e profetëve të egër tani janë plot fole dallëndyshesh! Amen!
Le të çelin vezët, me emër të asaj, që duhet të ngjajë, edhe nëse askush, nuk beson, ose nuk do të besojë, se do të ngjajë! Hasana! Hasana!
Si ta shpik një telefon, të bisedoj me ëndrrat?
2013

## PRINCI I LULEVE

Ca erëra në Currila i mësojnë yjet të artikulojnë abetaren e metaforave të mia!
E dashur! Ti mund të hysh brenda në argjend, të ecësh shtigjeve në brendësi të stolive ilire. Po kë do të gjesh? Kë do të takosh vallë?
Në mbretërinë e luleve vajtuese ç'trishtim është të jesh Princ i tyre!
2013

## VETMIA PREJ BLETE

Shihmëni, ju lutem!
Do të gëlltis këtë rrugë, që kam përpara si zjarrngrënësi shpatën prej flake!
Një gjethe e përcjell tek mëhalla e vogël e gushëkuqëve, ku dëgjon e mahnitur gjithçka!
Atdheun e rikrijoj edhe tek një lule!
Kaq është vetmia ime prej blete!
2013

## TATUAZHE TË IKONOKLASTISË

Limfa shpërthen! Duke rrokullisur me vertik gurët e pllajave!
Ç'është ky ujë i mbyllur në një amforë bronxi, si këmba në këpucën fatale?
Engjej të uritur! Ushqehuni, me gurë varresh!
Ah, Princesha e Pluhurtë e Kalbjes!
O, Zot, nga sperma e kafshëve bëj kerubinët e tu!
Nga sperma e njerëzve ngjizen veç përbindësha!
Dhe unë do t'i gërvisht tërë statujat me tatuazhe të ikonoklastisë!
2013



## ...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte një përmbledhje e shumë gjërave, një pjesë të mbetura. Ishin zgjedhur të tilla për të afruar shumë shkrime, që kishin mbetur prej kohësh, por edhe që autori i kish lënë në pamundësi të botimeve, që kishin më shumë bashkëkohësi.

Panajot Barka na erdhi me një shkrim kushtuar Akademisë së Shkencave, ku shprehte mendimin e tij dhe rrugëtimin e ri të këtij institucioni aq të përfolur. Shtjellimi i z.Barka ishte shumë profesional por edhe me argumente, që vinë nga formimi i tij dhe mbi të gjitha pavarësia e mendimit. *E vërtetë është gjithashtu se një pjesë e rëndësishme e trupës akademike vjen nga realiteti i akademisë komuniste, në të cilën, sipas Oliver Schmitt, "modelet sunduese të mendimit janë të ndikuara fort nga ideologjia nacional-staliniste e diktaturës komuniste..." Ndërsa sipas Arshi Pipës, këto modele midis të tjerave kanë shërbyer për të "përhapur e nxitur ksenofobinë, sllavofobinë, izolacionizmin,....".* Për fat të keq, feedback mungoi krejtësisht. Që do të thotë se vetë atyre u duhet nga njëra anë të mohojnë një pjesë të pohimeve të tyre "shkencore", që është më e thjeshta, shkroi ai. Reagimi ka qenë i zbehtë sepse pjesa e prononcimit, lidhur me Akademinë, është bërë njësoj si futbolli, ku reagojnë të gjithë. Z.Barka ishte i trishtuar për këtë, por më shumë mungesën e reagimit të kolegëve të vet. Lluka Qafoku na përcolli një shkrim të Abedin Prezës dhe që redaktori e ka vonuar pak. Ai kishte bërë një aludim të drejtë për atë që duhet për historinë shqiptare. *"Historianët e rrymës së kundërhistorisë, të kësaj rryme të re në histori, kanë marrë përsipër pastrimin e historisë nga falsifikimet dhe të nxjerrin në dritë të vërtetat e historisë, pavarësisht se mund të preken mitet e kohëve të shkuara apo heronjtë e ditëve tona dhe do të ndryshojnë për mirë a për keq historinë e falsifikuar të mësuar deri më sot"*, shkroi ai. I pasionuari pas gjërave të historisë dhe koleksioneve, Armand Plaka, na kish sjellë diçka që lidhet me pasionet e tij. Deri në momentet e fundit dhe më pas, madje, ai ka kërkuar të ndërrojë shumë pasazhe, i fiksuar deri tek detaji më i vogël. Ai shpjegoi pasionin e tij, por edhe solli përgjigje për temën e tij të preferuar tashmë, që lidhet me "*dekriptimin e dosjeve të CIA-s, të cilat pas skadimit të afateve ligjore tashmë prej vitesh i janë nënshtruar aksesit të lirë apo pjesërisht të lirë nga individët e grupimet e interesuara, e ndër ta, edhe shqiptarët*". Duhet thënë se shqiptarët asnjëherë nuk do referojnë si duhet, lidhur me të. Orges Spahiu na kish sjellë një shkrim përshkrues të aktivitetit të tij atit, shkrimtarit të njohur Xhevahir Spahiu. Ai përshkruan të dy udhëtimet me të atin në Francë, pas botimit të librave të autorit, këtë herë me titullin "Urgjenca", shqipëruar nga Aleksandër Zoto dhe Viktor Bakillari, të cilët kanë përzgjedhur me elegancë dhe një kujdes të veçantë poezi të shkurtra apo "Shkurtima" fjalë e krijuar nga vetë poeti. Në përgjithësi mund të themi se ishte një numër jo i keq, por pa pjesë krijimtarie dhe kjo duhet quhet një minus i madh për redaktorin.

P

PERSONAZH

*Arsyeja pse At Zef Pllumi nuk ishte i dashur për klerikët është bërë e njohur vite më parë nga "GSH" dhe tashmë duket disi e habitshme: Ai kishte një mentalitet të "shkuar" për superiorët françeskanë dhe se nuk përshtatej tashmë me Kishën e 'shndërruar sipas modelit të tyre'...*

# At Zef Pllumi: Po vuaj më shumë në këto vite sesa në burg

NGA BEN ANDONI

Vijon nga faqja 13

Arsyeja, që është bërë e njohur vite më parë nga G.Sh, ishte disi e habitshme: Ai kishte një mentalitet të "shkuar" për ata dhe se nuk përshtatej tashmë me Kishën e 'shndërruar sipas modelit të tyre'. I njëjti personazh, i cituar nga GSh, do të shprehej se: *"Nëse i hedhim një sy arkivit të tij, që unë kam pasë fatin ta shoh kur At Zefi ishte në Tiranë, vërejmë një grumbull me letra drejtuar At Zefit nga Eprorët e tij, ku në këto letra nuk mungojnë kritika dhe kërcnime deri dhe me perjashtimin nga Urdhni", thotë kleriku anonim, duke dëshmuar se këtë gjë e thoshte edhe At Zefi me shumë dhimbje dhe me lot në sy. "Po vuaj ma shumë në këto vite nga eprorët e mi sesa nga vitet që kam kaluar në burg, për arsye se unë e dijshem dhe e pritshem një gjë të tillë prej komunizmit, ndërsa prej eprorve dhe misionarve nuk e kuptova këtë sjellje të tyre".*



At Zef Pllumi

Meshtari i njohur, njohës shumë i mirë i dogmës ka renditur një varg arsyesh, që e ndihën Padër Zefin të shkruante në letrën e tij të datës 15 qershor 1998, drejtuar provincialit At Flavio Kavallinit si dhe etërve të tjerë kapitullar:

*"Letra drejtue Kongregacionit të Ungjillzimit të popujve nuk u nderon aspak sepse aty paraqitet inati kundra njanit që thirret «confratello» e përveç ksaj, paraqitet nji moskuptim i thellë për veprimtarit e ungjillëzimit. Kur deklarohet botënisht se "Provinca Françeskane nuk asht aspak e interesueme për një shtypshkrojë, ju tregoni se nuk doni me dijtë kurrgja për traditën kishtare françeskane në Shqipni, të cilat kjen pararojat në frontin e shkollës e të kulturës, të dijës dhe të shtypit, dhe nga kjo gjithnji gëzon respekt. Të deklarosh se: nuk duem me njoftë traditën, don të thotë se don të rritësh bimë pa rrajë".*

Dhe Padër Zefi nuk ngelet këtu. Ai është shumë i trishtuar me të gjithë situatën: Sipas tij: kjo deklaratë bie në *"injorancë dhe kundërshton traditën e historinë e Kishës e të Provinçës, të cilat i kanë dhanë popullit tonë monumentet ma madhështorë të gjuhës e kulturës, ndër të cilat përfshihet edhe Revista 'Hylli i Dritës'".*

*-*-*

**Letra e eprorit Flavio Cavallini**

**(Drejtuar Shkëlqesisë së tij Card Jozef Tomko, Perfekt për Ungjillzimin e popujve)**

**Shkodër, 06.05.98**
**Prot. PR. 22/98**

Shkëlqesi e nderuar,
Nga informata jo të drejtpërdrejta jemi njoftuar për faktin se bashkëvëllau ynë p. Zef Pllumi, nga kuvendi i Shna Ndout Tiranë, pa autorizimin e Eprorit të vet rregulltar, ka bërë kërkesën dhe ka marrur një ndihmë të përshtatshme për zëvendësimin e makinërive të një tipografie (me një shtypshkronjë më të mirë) për të cilën Provinca Françeskane Shqiptare nuk është e interesuar aspak.

Të mbledhur në Kongresin Kapitollar, ju lutemi që ta rishikoni kërkesen dhe ta ndryshoni kontributin në ndihmë të iniciativave të tjera të nevojshme për këtë popull shqiptar.

*Kongresi Kapitullar*
*Fr. Flavio Cavallini*

---

**Shkëlqesia e tij.**
**Card Jozef Tomko**
**Perfekt për Ungjillzimin e popujve**
**Via propaganda**
**00187 Roma**

**Për dijeni:**
**Shkël. së tij.**
**Mons. Giovanni Bulaitis**
**Nunci Apostolik**
**Tiranë**

I nderuar. At Zef Pllumi
Kuvendi Françeskan
Tiranë

**Letra e pader Zef Pllumit (drejtuar eprorëve të provinçës françeskane në shqipëri**

Pax et Bonum

Shumë të nderuem etën kapitullarë të Provincës françeskane në Shqipëri,
Shkodër

Letra drejtue Kongregacionit të Ungjillzimit të popujve nuk u nderon aspak sepse aty paraqitet inati kundra njanit që thirret «confratello» e përveç ksaj, paraqitet nji moskuptim i thellë për veprimtarit e ungjillëzimit. Kur deklarohet botënisht se "Provinca Françeskane nuk asht aspak e interesueme për një shtypshkrojë" (*Provinca Françeskane atë kohë ishte e drejtuar prej disa misionarëve të huaj me në krye At Flavio Kavalinin*) ju tregoni se nuk doni me dijtë kurrgja për traditën kishtare françeskane në Shqipni, të cilat kjen pararojat në frontin e shkollës e të kulturës, të dijës dhe të shtypit, dhe nga kjo gjithnji gëzon respekt. Të deklarosh se: nuk duem me njoftë traditën, don të thotë se don të rritësh bimë pa rrajë. Kjo deklaratë bjen në injorancë dhe kundërshton traditën e historinë e Kishës e të Provinçës, të cilat i kanë dhanë popullit tonë monumentet ma madhështorë të gjuhës e kulturës, ndër të cilat përfshihet edhe Revista "Hylli i Dritës".

**Vëllau i juej në Shën Françeskun**
**Fr. Zef Pllumi**
**Tiranë, 15-06-1998**

Opinioni i Ditës

# Mafia shqiptare një institucion, që duhet "vlerësuar"

Nga Ben Andoni

*(vijon nga faqja 1)*



... asgjë. Anipse deklarata e kryegjyqtarit të Vlorës ishte e frikshme: Në gjykatë vijnë vetëm punëtorët, jo organizatorët e kultivimit të kanabisit. Të paktën në tre vjet që ai e kish drejtuar këtë gjykatë, në bankën e të akuzuarve nuk kish parë të ulej qoftë edhe një i vetëm organizator i kultivimit të kanabisit. Gati një dekadë më parë, media zbuloi shtegtimet e shumë banorëve lokalë nga vende të ndryshme të Shqipërisë në drejtim të Lazaratit. Për shumë syresh destinacioni dihej ose kamuflohej me Greqinë, por mjaftonte puna në parcelat e hashashit dhe ajo sasi parash që sillnin në shtëpi për të jetuar, që t'i fashiste të gjitha hamendësitë. Nga ana e tij, sërish shteti dhe strukturat e veta *ishin të paditura*. Publiku po ashtu. Ndërkohë që referimet nga agjenci sigurie, policitë e vendeve fqinjë dhe institucione sigurie e precizonin qartë: MAFIA shqiptare po kthehet në një institucion. Robert Saviano do ta qartësonte hapur imazhin e saj në një intervistë për gazetaren Xhunga: "*Ekziston shumë fuqishëm dhe për mendimin tim, është një nga mafiet e panjohura më mizore në botë. Është disi më pak e njohur se bën më pak gjëra. Organet gjyqësore, Policia Financiare, karabinierët, Antidroga, Anti-Mafia kanë shumë dokumente për praninë e MAFIA-s shqiptare në Itali. Duhet bërë një dallim i madh mes mafies shqiptare kosovare, mafies shqiptare të Shqipërisë dhe mafies shqiptare të Maqedonisë*". Dhe, logjika e njohësit të MAFIA-s vazhdonte e strukturuar: Është politika ajo që ka nevojë për MAFIA-n, pasi strukturat e saj përbëjnë sipërmarrje. Që do të thotë *brende*, njëlloj si BMW-ja apo Microsoft-i. Në këtë logjikë, ai bënte edhe bilancin e këtij biznesi për vendin e tij, e cila sipas prokurorisë kombëtare Anti-MAFIA, kapte plot 100 miliardë euro në vit. Në këtë hulli, kuptohet se futej dhe ajo shqiptare...E si mund të heqësh dorë nga një shifër e tillë?-bënte në fund pyetjen retorike.

Pak ditë më parë, organet e policisë shqiptare janë konfrontuar me institucionet e ushtrisë sa i përket nxjerrjes jashtë funksionimi të radarëve. Debati u fashit disi në ditët e fundit, por nxori dhe njëherë faktin se ajo që flitet nuk është e gënjeshtërt. Të fortët janë të mbrojtur, sepse pas tyre gjenden gjithmonë politikanët. Nuk është e vështirë të kuptosh simbiozën krim-politikë, nëse gjykon qoftë edhe prej gjuhës së trupit të politikanëve apo t'u dëgjosh ligjërimin. Politikanët sulmojnë me akuza dhe kanë ligjërime si krimi, sepse pas tyre gjithnjë gjenden "*të fortët*". Mjafton të shikosh eskortat në rrethe të miqve të politikës dhe kupton sesi funksionon shteti ynë. E krimi, që është ende i pavlerësuar strukturalisht, ka kapur gjithçka, duke i shtrirë ngado tentakulat. Rasti i Elbasanit ishte thjesht një indikator, ku mund të kuptosh se deri ku sfidohet policia. Kurse më globalisht, njeriu e shikon sfidën nga privatizimet dhe e ndjek me pasurimet e shpejta, e shikon nga beneficet, e shikon nga trafikimet. E shikon nga emërimet, por edhe *background*-et e shumë personazheve të policisë në dy dekadat e fundit.

Lufta e Kosovës solli në dritë aspekte të reja të aktivizimit të MAFIA-s, që rridhte me trafikun e armëve, por edhe në përfshirjen e krimit të organizuar. Shoqëria civile kosovare tashmë po i denoncon me forcë dhe vazhdimisht në media, por pa mundur të bëjë gjë më shumë. Në botime të huaja është folur në mënyrë të detajuar, por sot krimi shqiptar pranohet se është institucion.

Një prej prokurorëve Anti-MAFIA në Itali, Cataldo Motta, i cili i ka të identifikuar mafiozët shqiptarë si nga më të rrezikshmit do shprehej pak kohë më parë, cituar nga mediat tona se: *"Krimi i organizuar shqiptar është bërë pikë referimi për gjithë aktivitetin kriminal sot. Gjithçka kalon nga shqiptarët. Rruga për drogën, armët dhe njerëzit, pra emigrantët ilegalë të drejtuar drejt Evropës është në duart e shqiptarëve"*. Ajo që i bashkon të gjitha referimet nga vende të ndryshme dhe arketipi, që është ngritur mbi mafiozin shqiptar është se ai ngjason shumë me atë italian burimor, e ka prirje madje edhe për mëvetësinë e vet. Rruga pothuaj ndjek të njëjtën trajektore: Të gjithë e kanë filluar me grabitjet e vogla, ndërsa pak nga pak janë shndërruar në pjesë të familjeve të krimit të "Cosa Nostra", duke ofruar *krahun e lirë* për t'u shkëputur me grupimet e tyre. Si dy pika uji, historia e shumë individëve ka si fill idilik historinë e personazhit kryesor të "Scareface" Toni Montana. Jo më kot, ky film sot e kësaj dite është tejet i ndjekur dhe i dashur në vend.

Duke filluar që nga SHBA dhe vende të tjera në Evropë problemi është se sot MAFIA shqiptare ka organizimin e saj dhe strukturat e ndryshme që kanë lidhje me njëra-tjetrën. Këtë e shpjegon lehtësisht një fakt, shpërhapja, shkëmbimi dhe eficenca e krimit me origjinë shqiptarë në vende të ndryshme.

Ka të ngjarë të zëvendësojë familjet "Cosa Nostra-s" si boshti i krimit amerikan, shpreheshin pak vite më parë zyrtarët e FBI-së për CNN.

Ne, vetë, jemi pjesë e një realiteti ku veprimtarinë e tyre e kemi përpara syve dhe Shqipëria është e mbushur me OJQ dhe institucione të huaja, që i ka si objekt ata, vetëm se ende nuk ka një studim mirëfilli për MAFIA-n shqiptare. Jo se nuk është e mundur, por gjykatat, policia dhe dëshmitë e individëve të ndryshëm paraqesin shumë handikape. Kurse në media, kanë involvuar zëra, që indirekt më shumë e përçudnojnë fenomenin dhe shterojnë debate në probleme anësore, duke e lënë të boshatisur fushë-studimin e saj. Projektet, shtuar me ato pak vëzhgime, më shumë japin sensacionin dhe gjetjet e policisë, kurse në thelb mungojnë studimet dhe fenomenologjia e problemit. *"Pavarësisht se krimi i organizuar shqiptar është reklamuar shumë në dekadën e fundit ka shumë pak kërkime shkencore që shpjegojnë në mënyrë sistematike dhe rigoroze fenomenin e kriminalitetit etnik shqiptar në mënyrë metodike. Gjithsesi, edhe ato studime mbështeten në raportimet sensacionale të mediave. Kjo e ka errësuar studimin e mëtejshëm shkencor dhe të thellë. Prandaj, në përgjithësi studimet mbi këtë fenomen janë me raste jo koherente dhe shpeshherë të pabesueshme"*, citohet një material nga policia belge, që e bëri CNN dhe një organ lokal belg. Dhe, po të ndjekësh trafikun, por edhe gjetjet e policisë, referohen tonalitete të tëra kanabis, që e kanë përshkruar Greqinë, Italinë e me radhë, përpos listës së kriminelëve që nuk i duket fundi.

Mafia shqiptare ose më saktë, Krimi i Organizuar Shqiptar tashmë është institucion dhe është verbëri, nëse ne e mohojmë si fakt. Çështja e parë është tashmë sesa do të mundemi ta studiojmë për të shkuar në origjinën e saj, për të gjetur prirjet që ajo prezanton për të ardhmen.

Kjo duket si e vetmja mënyrë për të nisur një rrugë përballje me të, por edhe për ta shikuar një fenomen që vendos për shumë problematika në vendin tonë. Ka kaluar shumë kohë për s'është vonë. MAFIA, me ato që referohet, e ka mposhtur Shqipërinë. Duhet quajtur fat, që ekonomistët tanë nuk dinë të gjejnë modulet të matin realisht xhiron e saj vjetore, sepse shifrat do na pataksnin. E jeta vazhdon, ata bëjnë për vete politikanë, korruptojnë lehtësisht gjykatësit shqiptarë dhe shteti në emër të drejtësisë... shtyp të varfrit.

Një prej prokurorëve Anti-MAFIA në Itali, Cataldo Motta, i cili i ka të identifikuar mafiozët shqiptarë si nga më të rrezikshmit do shprehej pak kohë më parë, cituar nga mediat tona se: "Krimi i organizuar shqiptar është bërë pikë referimi për gjithë aktivitetin kriminal sot. Gjithçka kalon nga shqiptarët. Rruga për drogën, armët dhe njerëzit, pra emigrantët ilegalë të drejtuar drejt Evropës është në duart e shqiptarëve". Ajo që i bashkon të gjitha referimet nga vende të ndryshme dhe arketipi, që është ngritur mbi mafiozin shqiptar është se ai ngjason shumë me atë italian burimor, e ka prirje madje edhe për mëvetësinë e vet.

Opinioni i Ditës

# Lotët e Gertës dhe mallëngjimi kolektiv i shqiptarëve

Nga Desada Metaj

(vijon nga faqja 1)



... të panjohur që përloti një sallë parlamenti. Madje aq prekës ishte fjalimi i saj, sa zyrtarë të lartë të qeverisë, përfshirë edhe kreun e ri të Kuvendit, u përlotën duke dëgjuar sa e rëndë ishte situata në fshatin shqiptar.

Po si ka mundësi që një hallexhie nga fshati, nga ato që me zor takojnë një herë në 4 vjet deputetin e zonës, ka gjetur hapur derën e parlamentit?! Madje ka folur në mikrofonin ku një herë në javë flasin dhe debatojnë ata që mbajnë përgjegjësi për situatën jo vetëm në fshat, por edhe në qytet. Si mundet që, një shoqëri dhe media hesht kur shteti falimenton përpara krimit siç ndodhi në Elbasan, qurravitet pas një fjalimi që është po aq i thjeshtë sa hallet që të qajnë dhe fshatarët te tregu i çdo lagjeje?! Përgjigjja për mua është shumë e thjeshtë: Në kohën dhe vendin e duhur, një show i tillë është mjeti më i mirë për të larguar vëmendjen nga ajo çka vërtet është problem në Shqipëri. Është mënyra që dikur Enver Hoxha zgjidhte për të kritikuar burokratët ndërsa vriste dhe burgoste intelektualët, është show i zgjedhur me kujdes nga skenaristët dhe regjisorët e shfaqjes: "Shqipëria ka vend për përmirësime".

Jo! Shqipëria nuk ka nevojë për ato që zonjës Gerta i kishin shkruar në fjalim. Shqipërisë nuk i duhen rrugë, por më parë i nevojitet që politika të shkëpusë lidhjet me krimin. Rrugë dhe ujësjellës mund të ndërtojë çdo kriminel që ka pushtet apo fije të forta me të. Por shteti dhe qytetaria vdesin kur krimi bashkëjeton me to. Jo, zonjë! Ata që ta kanë shkruar fjalimin dhe të kanë mësuar aktrimin, e dinë më mirë se ti se nuk është rilindja e fshatit halli që përlot Gramoz Ruçin. Është show dhe roli që pushtetit duhet të të mësojnë për ta bërë këtë popull të besojë se problemi më i madh i fshatit qenka bujqësia. Jo, Gerta! Të kanë gënjyer ty dhe ndoshta ti veten kur thua se nuk dinë si votojnë në fshatin tënd. Që atje nuk e njohin se kush është në opozitë dhe në pushtet. Unë jam nga qyteti, por kam qenë në fshat në fushatë dhe ditën e zgjedhjeve. Dhe e di shumë mirë që votat në fshat janë kryesisht kolektive dhe për shkak të varfërisë ekstreme ato blihen, në shumë raste dhe lirë. Dhe a e di kush i blejnë? Këta "të fortët" e lidhur me pushtetin. Që më pas fitojnë tenderin e rrugës dhe ujësjellësit të fshatit tënd. Dhe e vjedhin. Po, po. E vjedhin dhe ujin e rruga nuk vijnë kurrë te ti, as te fshati yt.

Se ti ke një Kristinë në fshat që qenka e mërzitur se nuk di të ardhmen e atyre që ka mbjellë. Por a ka mbjellë dikush hashash në fshatin tënd, Gerta? Sepse dukeshe vërtet e informuar dhe ndoshta nuk e di që fshati yt dhe qyteti im janë prodhues dhe eksportues të frikshëm të hashashit. Që po formojmë një brez që ëndërron të jetë shpërndarës droge, dhe kjo, e dashur Gerta, është më e frikshme se mungesa e rrugëve në fshat. Ndaj sot, më shumë se ti që ndoshta ke ajrin e pastër, ushqim bio dhe hapësirë për të qarë hallet edhe në parlament, që ke shansin dhe të përlotësh Gramoz Ruçin që nuk i dridhet qerpiku edhe kur i thonë 'kriminel', mua më vjen keq për shqiptarët. Për këtë popull në kufijtë e mjerimit njerëzor dhe qytetar, që po humb çdo vlerë. Të rinisë që ka aspiratë pasurimin e shpejtë dhe me punë të "pista". Ndjej më shumë keqardhje për një brez të tërë që po rriten dhe edukohen pa personalitet, marionetа në duar të politikës dhe krimit.

Më vjen më shumë keq për fëmijët që do vazhdojnë të rriten këtu, me sistem të paqartë dhe nivel të ulët arsimor. Më dhimbsen më shumë ata që përpiqen dhe punojnë për të ndryshuar diçka, që paguhen shumë mirë dhe i japin këtij shteti taksa për shërbime që nuk i marrin kurrë. Më dhimbsen prindërit e mi dhe pensionistët e tjerë që gënjehen me rritje qesharake pensionesh dhe nuk shkojnë dot kurrë në një spital privat edhe pse kanë punuar me ndershmëri gjithë jetën. Por më shumë se të gjithë këta, Gerta, më dhimbsesh ti. Lotët e tu dhe aktrimi i tepruar që të mësuan të bësh. Sepse vetëm kur shoh shfaqje të tilla kuptoj që, ndryshe nga sa the ti, Shqipëria nuk bëhet. Sepse kemi ende mungesë të theksuar dinjiteti, trashëgim i hidhur i shtypjes 50-vjeçare të komunizmit. Sepse kemi ende njerëz të rinj në moshë si ti, Gerta, që pranojnë të bëjnë show në emër të një pushteti që s'ka rëndësi nëse, siç thua ti, i rreh zemra majtas apo djathtas. Ndaj, për të gjitha këto, unë mendoj se ky vend vështirë të bëhet, derisa dinjiteti të rikthehet si vlerë e një shoqërie që ende përlotet me skenarët e telenovelave të shkruara nga ata që mbajnë përgjegjësi për llumin ku jemi zhytur.

**"Opinion.al"**

BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

## HOROSKOPI

### DASHI
Krijimtaria vazhdon të jetë pika juaj e fortë, falë Uranit që ju mban nën krahun e tij mbrojtës. Do ndërmerrni projekte të reja. Do arrini të krijoni një atmosferë të këndshme, duke ndryshuar rutinën e zakonshme me gjëra të bukura.

### DEMI
Falë Marsit favorizues iniciativat tuaja do jenë më shumë se të kënaqshme. Edhe Venusi premton momente të bukura në çift. Jeni më pak të shqetësuar. Frenoni tendencën për të ndërmarrë shumë iniciativa që të përfundoni disa prej tyre të paktën.

### BINJAKET
Me Saturnin kundër, mos lejoni që çështjet e jashtme t'ju shqetësojnë më shumë se duhet. Kur ta shihni të nevojshme, mblidhuni në vetvete dhe do gjeni paqe. Me Venusin inkurajues, do merrni nga partneri përgjigjet e duhura në harmoni të përkryer me pritshmëritë tuaja.

### GAFORJA
Marsi dhe Venusi në trekëndësh premtues ju dhurojnë një moment pozitiv, jeni të mbushur me energji, dinamikë dhe të etur të vini në praktikë idetë tuaja të shumta. Pranoni ftesën e një miku i cili e di se sa e mërzitshme është rutina e përsëritur.

### LUANI
Bëni zgjedhjet tuaja. Megjithëse nuk e dini se cili do jetë rezultati i tyre, jeni të qetë se keni bërë të gjitha përpjekjet e mundshme. Mund të lindë papritur një ndjenjë për një kolegun tuaj ose eprorin. Kujdes.

### VIRGJERESHA
Keni përreth persona entuziastë, falë ideve tuaja të shumta, por në lidhje me qëllimet e tyre kini kujdes jo çdo gjë që shkëlqen është flori! Jeni beqarë? Me Neptunin kundër, mësoni të jeni më përzgjedhës dhe të kthjellët në gjykimet tuaja.

### PESHORJA
Me Hënën dashamirëse nga qielli i Ujorit, do të sinkronizoheni në të njëjtën frekuencë me të afërmit tuaj për t'i bërë marrëdhëniet më të plota dhe të thella. Mos vazhdoni të kërkoni jashtë atë që mendoni se do t'ju bëjë të lumtur. Shikoni brenda vetes.

### AKREPI
Venusi që i buzëqesh shenjës tuaj ju ndihmon të shprehni më mirë dhe pa frikë ndjenjat, duke tejkaluar tendencën tuaj proverbiale për të qenë i ndrojtur. Përpiquni të jeni më optimist edhe pse nganjëherë fati nuk është në anën tuaj.

### SHIGJETARI
Urani bashkëpunues i hap rrugë përvojave interesante në fushën e komunikimit multimedial, për të gjetur punë përmes tyre ose në internet. Favorizuese sektorët e punës të lidhur me televizionin, spektaklet ose muzikën. Mos humbisni kohë.

### BRICJAPI
Marsi ju mbështet. Me dinamizmin dhe emocionet që janë të rëndësishme për ditë të veçanta, do filloni të ndjeheni mirë përsëri. Do jeni më të sigurt në vetvete dhe të vendosur për të marrë atë që dëshironi.

### UJORI
Me Hënën në qiellin tuaj, do organizoni kontakte shoqërore duke kombinuar takime me personalitete të shquar që mund t'ju ndihmojnë. Marsi mik do ju bëjë të ndjeheni të vlerësuar në dashuri. Tregohuni shumë bujar me partnerin tuaj.

### PESHQIT
Dialektika juaj delikate, intuita e sofistikuar dhe humori i kërkuar do t'ju ndihmojnë të tërhiqni më shumë admirues dhe miq të rinj. Mos i jepni shumë konfidencë personave pak të qartë dhe përpiquni të fitoni bashkëpunimin e atyre që vlerësoni.

## Fjalëkryqi (1)



37. Italia në Internet.
38. Fillojnë vonë.
39. Krijoi James Bond.
40. Ishulli i Odiseut.
42. Van der portier.
43. Një karamele aromatike.
44. Mund të shkojnë... nga frika.

VERTIKAL
1. Bëhet duke vënë në lojë.
2. Pak origjinale.
3. Thahet me bonifikim
4. Në fund djathtas.
5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
7. Hidhet një për shesh.
9. Kokëkuqja në pit stop.
10. I famshëm ai i Sizifit.
12. Është në pikën më veriore e Shqipqërisë.
13. Një diktator shtypës

VERTIKAL

1. Të çara ato të Shollohov.
5. Filloje luftën.
6. Liszt kompozitor.
8. Marsi në Areopag.
9. Kështu fillon filmi.
11. Gjysmë linear.
12. Një freskues në tavan.
18. Është gazeta Panorama.
20. Mund të jenë kamikaze.
21. Masat pa kufij
23. Venier e spektaklit italian.
25. Sophia e kinemasë.
26. Safin tenist.
29. Është makut, i pangopur.
31. Është faqe ene.
32. Një kafshë qe hap... galeri.
33. Një fytyrë e keqe.
35. Preken nga sindroma Basedow.

14. Lëvizja Socialiste Spanjole.
15. I kanë çift radhët.
16. Janë llahtare.
17. Poeti kur nuk pi.
19. Fillojnë periudhën.
22. Omar që qe aktor.
24. Si sezonale.
25. Janë banorët në Riga.
26. Carey këngëtare.
27. Nuk i tregohen babait.
28. Bëjnë arte me re.
29. Kush ka... e ka humbur toruan.
30. Një stacion orbital.
31. Fillojnë profesionin.
33. Gibernau i MotoGp.
34. I kanë të ndryshme tutat
36. Gjysmë ditari.
38. Varet me re.
41. Kufijtë e kujtesës.
42. Sapo fillonjë.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Gustav kompozitor.
6. Në krye të kryesisë.
7. Lexohet në pentagram.
11. Sastre aktore.
12. Gjysmë akordi.
15. Dhjetë angleze.
16. Satira pë zë.
18. Është situata e tensionuar.
21. Pak teatrale.
22. Bëhet me mea culpa.
24. Fundi i një samurai.
25. Mbeten në fund.
26. Lind në kokë.
28. Në radhë të parë.
29. Inicialet e Camus
30. Një verë në Paris.
31. Partizani i vogël... në një film tonin.
33. Litra pa kufij.
35. Është fatë.
36. Një pjesë e kinematografisë.
37. Një pjesë e akademisë.
39. Kufijtë e tretjes.
40. Mbyll të çarën.
41. Erik çiklist.
43. Një pjesë e medaljes.
44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës
51. Mbyllin një spital.
52. Mbyllet me derezë.
53. Ishin kalorësit si Rolandi
54. Ndal në... kryqëzim.

VERTIKAL
1. Janë enigmatikë.
2. Mund të jenë parabolike.
3. Ishte xhelozja e Olimpit.
4. Kufijtë e lëvizjes.
5. Fillojnë radhitjen.



6. Janë kushte.
8. Totem pa ekstreme.
9. Mbyllin kanate.
10. Shoqëronte Edipin e verbër.
13. Është gjeli.
14. Moore aktore.
17. Janë forcat e Reneas.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin dritaren.
26. Fillojnë matjet.
27. Duhen ruajtur.
32. I bën një serenatë Rosina-s.
34. Gjysmë rabini
38. Mustafa.. Ataturk.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Ai i muzave është Helikona.
45. Një pjesë e gadishullit
47. Muzika e Eminem.
49. Fillojnë operacionin.
50. Kapen të parat.
52. Kufijtë e drejtëzës.

## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 8 | 7 | | | | 9 | | |
| | | 2 | 7 | | | | 8 | 1 |
| 5 | | | | 4 | | | 6 | |
| | | | | | 3 | 5 | | 2 |
| | | | | | | | | |
| 8 | | 3 | 4 | | | | | |
| | 6 | | | 1 | | | | 3 |
| 3 | 9 | | | | 2 | 1 | | |
| | | 8 | | | | 7 | 5 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 3 | 7 | 4 | 8 | 9 | 6 | 5 | 2 |
| 8 | 5 | 9 | 2 | 1 | 6 | 4 | 7 | 3 |
| 6 | 2 | 4 | 3 | 5 | 7 | 9 | 1 | 8 |
| 4 | 8 | 3 | 9 | 2 | 1 | 7 | 6 | 5 |
| 9 | 1 | 6 | 5 | 7 | 8 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 7 | 2 | 6 | 4 | 3 | 1 | 8 | 9 |
| 3 | 6 | 5 | 7 | 9 | 4 | 8 | 2 | 1 |
| 7 | 4 | 1 | 8 | 3 | 2 | 5 | 9 | 6 |
| 2 | 9 | 8 | 1 | 6 | 5 | 3 | 4 | 7 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ■ | M | A | R | I | E | ■ | K | O | H | A | ■ | A | K |
| F | I | L | L | I | ■ | D | O | M | A | T | E | ■ | R |
| R | A | F | T | ■ | M | I | M | ■ | R | ■ | ■ | S | E |
| A | ■ | A | ■ | P | E | R | I | P | A | T | I | ■ | M |
| N | H | ■ | P | A | K | E | T | I | M | E | T | ■ | T |
| Z | E | M | E | R | A | K | E | T | ■ | S | ■ | T | I |
| ■ | F | I | D | A | N | E | T | ■ | V | E | T | E | M |
| S | E | N | A | T | I | ■ | I | B | E | R | I | K | E |
| ■ | S | E | N | E | K | A | ■ | L | L | A | P | A | T |
| ■ | T | R | E | ■ | E | L | S | A | ■ | T | T | ■ | ■ |
| L | I | V | ■ | E | T | A | ■ | K | A | ■ | A | D | ■ |
| N | ■ | A | A | R | ■ | N | J | E | ■ | A | P | E | L |

FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| D | A | L | A | I | ■ | V | A | K | A | N | T | E | ■ |
| E | D | E | N | ■ | P | ■ | N | A | D | I | A | ■ | M |
| R | R | ■ | E | M | I | R | E | T | ■ | T | R | I | O |
| T | E | S | T | ■ | R | ■ | T | A | T | ■ | E | O | L |
| ■ | S | M | ■ | N | O | T | A | R | E | T | ■ | N | L |
| K | A | ■ | ■ | A | M | E | R | I | K | A | N | E | ■ |
| E | ■ | H | ■ | P | A | M | ■ | ■ | A | ■ | D | S | H |
| ■ | K | O | L | O | N | A | ■ | O | T | ■ | E | C | E |
| T | U | N | E | L | E | T | ■ | P | ■ | E | R | O | S |
| O | R | ■ | A | I | T | ■ | K | E | S | T | I | ■ | A |
| K | A | N | ■ | ■ | ■ | S | A | R | A | H | ■ | E | P |
| E | T | J | A | ■ | C | I | T | A | T | E | ■ | T | I |

## Argëtim filozofik

- Gjërat më të thjeshta janë njëkohësisht edhe më të jashtëzakonshmet, vetëm të mençurit mund t'i shohin ato.

- Të të duan thellësisht - të jep forcë; të duash thellësisht - të jep guxim!

Lao Tzu

- "Mik i mirë është ai që di gjithçka për ty dhe megjithatë vijon së qëni miku yt".

Elbert Hubbard

Argëtim filozofik



## KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 6 | 10 | 2 | ■ | ■ | 15 | 10 | ■ | ■ | 15 | 1 | 11 |
| 1 | 9 | 3 | 7 | ■ | 8 | ■ | 2 | 7 | 16 | ■ | 11 | 1 |
| 4 | 1 | 10 | ■ | 5 | 3 | 9 | 3 | 8 | 2 | 12 | 3 | 8 |
| 2 | 9 | ■ | 16 | 6 | 4 | 2 | 8 | 6 | 9 | 2 | ■ | ■ |
| 18 | ■ | 12 | 1 | 15 | 2 | 8 | 1 | 11 | 2 | 7 | 8 | 3 |
| 6 | ■ | 11 | 1 | 15 | 9 | 1 | 8 | ■ | 1 | ■ | 1 | 8 |
| 4 | 3 | 1 | ■ | 3 | 8 | ■ | ■ | 11 | 16 | ■ | 8 | 2 |
| 2 | ■ | 7 | ■ | 9 | 3 | 2 | 4 | 3 | ■ | 8 | 2 | 16 |
| ■ | 15 | 2 | 7 | ■ | ■ | 7 S | 6 O | 10 D | 1 A | ■ | 16 | 6 |
| 7 | 3 | 12 | 9 | 3 | 8 | ■ | 11 | ■ | ■ | 17 | 6 | 11 |
| 1 | 11 | 3 | ■ | 11 | 6 | 4 | 10 | 9 | 1 | ■ | 9 | 6 |
| 8 | 3 | 8 | ■ | 1 | 18 | 10 | 3 | 9 | 1 | ■ | 3 | 17 |

## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I | R | ■ | S | E | R | B | ■ | B | I | D | E | T |
| B | E | L | A | M | I | ■ | S | ■ | ■ | R | N | I |
| I | I | ■ | H | I | P | O | T | E | Z | A | T | ■ |
| Z | ■ | P | A | R | A | K | A | L | I | M | E | T |
| A | N | E | T | A | R | E | T | ■ | L | A | ■ | A |
| ■ | ■ | R | I | T | I | ■ | U | ■ | I | T | A | ■ |
| A | T | E | ■ | E | M | ■ | T | A | ■ | I | R | O |
| K | E | N | E | T | E | ■ | I | T | A | K | A | ■ |
| T | K | D | ■ | ■ | T | E | ■ | A | N | ■ | T | A |
| U | N | I | O | N | ■ | M | R | ■ | ■ | T | ■ | K |
| A | I | ■ | M | I | S | I | O | N | A | R | E | T |
| L | K | S | ■ | T | U | R | I | S | T | E | T | ■ |

## Thënie të mençura

- Fjalët kanë fuqinë e të shkatrruarit dhe të krijimit; kur fjalët janë të sinqerta dhe të këndëshme mund të ndryshojnë botën.

- Asgjë e gjallë s'duhet vrarë, as insekti apo kafsha më e vogël, sepse çdo jetë

- Fol vetëm atëherë, kur ajo çfarë ke për të thënë është më e bukur se heshtja...

- Dora e butë thyen edhe gurin më të fortë. Fjala e ëmbël zbut dhe zemrën më të egër...!

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

